

**DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR  
I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË  
VUSHTRISË 2026 – 2034**



## PËRMBAJTJA

1.	HYRJE .....	6
2.	KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE.....	7
	2.1. DIREKTIVA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR E BASHKIMIT EVROPIAN .....	7
	2.2. PROCEDURA E VSM-së.....	7
	2.3. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së .....	7
	2.4. STRATEGJIA 2020 E BE-së .....	8
	2.5. KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT .....	8
	2.6. HISTORIKU LEGJISLATIV DHE ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE.....	9
3.	METODOLOGJIA E PUNËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL.....	10
	3.1. QASJA METODOLOGJIKE E PËRGJITHSHME .....	10
	3.2. FAZA E PËRCAKTIMIT TË FUSHËVEPRIMIT .....	10
	3.3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TË MJEDISIT .....	10
	3.4. IDENTIFIKIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE DHE TREGUESVE .....	10
	3.5. VLERËSIMI I ALTERNATIVAVE DHE SKENARËVE TË ZHVILLIMIT .....	10
	3.6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE.....	11
	3.7. MASAT E MITIGIMIT DHE REKOMANDIMET MJEDISORE.....	11
	3.8. KONSULTIMI PUBLIK DHE INSTITUCIONAL .....	11
	3.9. MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....	11
	3.10. KUFIZIMET E METODOLOGJISË.....	11
4.	ANALIZA E GJENDJËS EKZISTUESE.....	12
	4.1. VEÇORITË MJEDISORE .....	12
	4.2. PEDOLOGJIA – PËRMBAJTJA E DHERAVE DHE GJEOLGJIA.....	12
	4.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE.....	15

4.4. LARTËSIA MBIDETARE .....	17
4.5. PJERTËSIA E SHPATIEVE .....	18
4.6. KUSHTET KLIMATIKE .....	19
4.7. BIOGJEOGRAFIA DHE BIODIVERSITETI.....	20
4.8. INFRASTRUKTURA TEKNIKE .....	23
4.9. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI PUBLIK.....	27
4.10. SHËNDETËSIA.....	28
4.11. INSTITUCIONET ARSIMORE.....	30
4.12. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI .....	31
4.13. ANALIZA SWOT .....	34
4.14. ANALIZA SWOT MJEDISORE – KOMUNA E VUSHTRRISË.....	35
5. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJËS SË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL .....	37
5.1. VIZIONI DHE SKENARET E ZHVILLIMIT .....	37
5.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHK-së SIPAS FUSHAVE TEMATIKE .....	38
5.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR.....	41
5.4. DISA NGA ASPEKTE KRYESORE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE .....	46
6. PARIME, QËLLIME DHE KRITERE MJEDISORE.....	50
6.1. QËLLIMET E VSM-SË .....	50
6.2. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QE KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL.....	51
7. TESTIMI I QËLLIMEVE TË PLANIT KUNDREJT OBJEKTIVAT TË VSM-së.....	56
7.1. MASAT E NEVOJSHME NË PZHK PËR MBROJTJEN E MJEDISIT .....	66
8. MONITORIMI .....	79
9. PËRFUNDIME .....	0
10. LITERATURA .....	2

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Matrica e përputhshmërisë për të vlerësuar qëllimet e PZHK-së kundrejt Qëllimeve të VSM-së (vazhdon në Tabelën) .....	57
Tabela 2 Efektet kumulative të projekteve të PZHK-së – Komuna e Vushtrrisë .....	73
Tabela 3 Përmbledhje e Problemeve Mjedisore dhe përgjigja sipas PZHK-së .....	76
Tabela 4 Tabela e monitorimit të zbatimit të VSM-së .....	80

## LISTA E HARTAVE

Harta 1 Karakteristikat gjeologjike të komunës së Vushtrrisë .....	14
Harta 2 Formacionet pedologjike të komunës së Vushtrrisë .....	14
Harta 3 Rrjeti hidrografik i komunës së Vushtrrisë .....	16
Harta 4 Harta hidrogjeologjike e komunës së Vushtrrisë .....	16
Harta 5 Hipsometria e terrenit të komunës së Vushtrrisë .....	17
Harta 6 Pjerrtësia e terrenit në komunën e Vushtrrisë .....	18
Harta 7 Vlera e llogaritur e biodiversitetit .....	22
Harta 8 Rrjeti i infrastrukturës rrugore .....	28
Harta 9 Shtrirja e institucioneve publike shëndetësore .....	29
Harta 10 Shtrirja e institucioneve publike arsimore .....	31
Harta 11 Ndikimi i PZHK-së në ekosistemet natyrore .....	70
Harta 12 Parashikimi i ndikimeve të PZHK-së në aspektin hapësinorë .....	72

## LISTA E SHKURTIMEVE

- **MMPHI** – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- **AMMK** – Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
- **BE** - Bashkimi Evropian
- **KK** - Kuvendi Komunal
- **GIS** – Sistemi i Informacionit Gjeografik
- **GNP** - Grimcat e Ngurta Pezull
- **NOQ** - Ndotësit Organik të Qëndrueshëm
- **OBSH** - Organizata Botërore e Shëndetësisë
- **OJQ** - Organizata Jo Qeveritare
- **VBJ** – Vendbanime Jo Formale
- **OZHM** - Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
- **PZHK** - Plani Zhvillimor Komunal
- **HZK** - Harta Zonale Komunale
- **PRRH** – Plani Rregullues i Hollësishëm
- **TeR** - Termat e Referencës
- **UNDP** - Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
- **UNEP** - Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara
- **VNM** - Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
- **VSM** - Vlerësim Strategjik Mjedisor
- **ZVM** - Zona e Veçanta e Mbrojtura

## 1. HYRJE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për politika, plane dhe programe përfaqëson një instrument të rëndësishëm për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore që në fazat e hershme të procesit të vendimmarrjes. Përmes këtij procesi synohet integrimi i çështjeve mjedisore në hartimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike, me qëllim orientimin e zhvillimit drejt qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes afatgjatë të mjedisit.

Koncepti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor buron nga politikat dhe dokumentet strategjike të niveleve më të larta të planifikimit hapësinor dhe shfrytëzimit të tokës, të cilat kanë karakter zhvillimor dhe vizionar. Për këto dokumente, përfshirë Planin Zhvillimor Komunal, realizimi i VSM-së është kërkesë ligjore dhe pjesë përbërëse e procesit të planifikimit.

Qëllimi i Raportit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë është identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme mjedisore që mund të rezultojnë nga zbatimi i këtij plani, si dhe shqyrtimi i alternativave më të favorshme nga aspekti mjedisor. Njëkohësisht, raporti synon të propozojë masa konkrete për parandalimin, zbutjen ose eliminimin e ndikimeve negative të mundshme që mund të rrjedhin nga propozimet e planit.

Metodologjia e ndjekur në hartimin e këtij raporti është në përputhje me Direktivën e Bashkimit Evropian 2001/42/EC “Për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve në mjedis”, si dhe me Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili përfaqëson transpozimin e kësaj direktive në legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Raporti i VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë është strukturuar në mënyrë që të përfshijë:

- Një përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor;
- Përshkrimin e vizionit, prioritetëve dhe objektivave kryesore të planit dhe lidhjen e tij me politikat, planet dhe programet e tjera relevante;
- Analizën e gjendjes aktuale të mjedisit dhe zhvillimet e pritshme në rast të moszbatimit të planit;
- Përshkrimin e karakteristikave mjedisore të zonave që mund të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme;
- Identifikimin e problemeve ekzistuese mjedisore që lidhen me planin; si dhe
- Objektivat e mbrojtjes së mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mënyrën se si ato janë marrë parasysh gjatë hartimit të raportit.

Në kuadër të raportit janë vlerësuar ndikimet e mundshme dhe të rëndësishme në mjedis, përfshirë shëndetin publik, florën dhe faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale dhe trashëgiminë kulturore, si dhe ndërveprimet ndërmjet këtyre faktorëve. Po ashtu, janë analizuar efektet kumulative dhe janë propozuar masa për parandalimin, reduktimin ose lehtësimin e ndikimeve negative mjedisore. Raporti përfshin gjithashtu shqyrtimin e alternativave të zhvillimit, vështirësitë e hasura gjatë përpilimit të tij, si dhe mekanizmat e monitorimit dhe raportimit.

Të dhënat dhe informacionet për Komunën e Vushtrrisë janë siguruar nga burime zyrtare të komunës, nga dokumentet ekzistuese planifikuese, përfshirë Planin e mëparshëm Zhvillimor Komunal, si dhe nga hulumtime dhe burime të tjera relevante.

Ky Raport i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë përbën një dokument të rëndësishëm për orientimin e zhvillimeve të ardhshme komunale, duke synuar që ato të jenë në harmoni me legjislacionin vendor për mbrojtjen e mjedisit, si dhe me direktivat dhe konventat ndërkombëtare.

## 2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

### 2.1. DIREKTIVA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR E BASHKIMIT EVROPIAN

Direktiva e Bashkimit Evropian 2001/42/EC mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis është miratuar më 27 qershor 2001. Kjo direktivë zbatohet për një gamë të gjerë të planeve dhe programeve publike, përfshirë ato që lidhen me shfrytëzimin e tokës, transportin, energjinë, menaxhimin e mbeturinave, ujërat, bujqësinë, pylltarinë, turizmin dhe sektorë të tjerë relevantë. Direktiva nuk i referohet drejtpërdrejt politikave, por planeve dhe programeve që përgatiten dhe miratohen nga autoritete publike në nivel kombëtar, rajonal ose lokal dhe që bazohen në dispozita ligjore, rregullative ose administrative.

Sipas Direktivës 2001/42/EC, Vlerësimi Strategjik Mjedisor është i detyrueshëm për planet dhe programet që:

- Përgatiten për sektorë si bujqësia, pylltaria, peshkimi, energjetika, industria, transporti, menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave, telekomunikimi, turizmi, planifikimi urban dhe rural ose shfrytëzimi i tokës, dhe që vendosin kornizën për miratimin e projekteve të ardhshme të listuara në Direktivën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM);
- Kërkojnë vlerësim sipas Direktivës për Vendbanimet (Habitats Directive).

Për planet dhe programet që nuk përfshihen drejtpërdrejt në këto kategori, shtetet anëtare janë të obliguara të zbatojnë procedurën e shqyrtimit (screening), me qëllim të përcaktimit nëse ato mund të kenë ndikime të rëndësishme mjedisore. Në rast se konstatohet një ndikim i tillë, realizimi i VSM-së bëhet i domosdoshëm. Kjo procedurë bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

### 2.2. PROCEDURA E VSM-së

Procedura e VSM-së përfshin përgatitjen e raportit të VSM-së, në të cilin identifikohen ndikimet e mundshme të rëndësishme mjedisore dhe alternativat e arsyeshme të planit ose programit të propozuar. Gjatë këtij procesi, autoritetet relevante dhe publiku informohen dhe konsultohen. Rezultatet e konsultimeve dhe raporti i VSM-së merren parasysh para miratimit të planit ose programit. Pas miratimit, autoritetet mjedisore dhe opinioni publik njoftohen, ndërsa ndikimet mjedisore monitorohen për të identifikuar në kohë efektet e papritura negative.

### 2.3. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së

Përveç Direktivës për VSM, ekzistojnë edhe direktiva të tjera të BE-së që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë proces dhe që janë të rëndësishme për shqyrtimin e çështjeve mjedisore. VSM-ja ka lidhje të ngushtë procedurale me Direktivën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), pasi vlerësimet strategjike vendosin kornizën për projektet konkrete. Gjithashtu, ekziston një lidhje e fortë me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet drejtpërdrejt në Direktivën VSM. Po ashtu, Direktiva Kornizë për Ujërat, në kombinim me Direktivën për Vendbanimet, kërkon vlerësime të koordinuara dhe harmonizim të procedurave ndërmjet instrumenteve të ndryshme ligjore.

## 2.4. STRATEGJIA 2020 E BE-së

Strategjia Evropë 2020 është një dokument kyç i politikave të Bashkimit Evropian, i cili ka rëndësi edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Kjo strategji synon zhvillim të zgjuar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke promovuar rritjen ekonomike, punësimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Strategjia përfshin shtatë nisma kryesore, ndër të cilat efikasiteti i burimeve dhe politika industriale për epokën e globalizimit janë drejtpërdrejt të lidhura me qëndrueshmërinë mjedisore. Objektivat e saj, si ulja e emetimeve të gazrave serrë me 20%, rritja e përdorimit të energjisë nga burime të ripërtëritshme dhe rritja e efikasitetit energjetik, janë relevante edhe për planifikimin lokal dhe duhet të integrohen në planet dhe procedurat e VSM-së, përfshirë Planin Zhvillimor të Komunës së Vushtrisë.

## 2.5. KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT

### 2.5.1. KONVENTA ÅRHUS

Konventa Århus, e miratuar më 25 qershor 1998 dhe në fuqi që nga viti 2001, garanton të drejtën e qasjes në informata mjedisore, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore. Ajo obligon autoritetet publike që të sigurojnë transparencë, përfshirje të publikut dhe marrje parasysh të komenteve të tij gjatë hartimit të planeve dhe programeve që kanë ndikim në mjedis, përfshirë dokumentet e planifikimit zhvillimor komunal.

### 2.5.2. KONVENTA ESPOO

Konventa Espoo, e miratuar më 1991 dhe në fuqi nga viti 1997, përcakton obligimet e shteteve për vlerësimin e ndikimeve mjedisore të aktiviteteve që mund të kenë efekte ndërkufitare. Ajo kërkon njoftim dhe konsultim ndërmjet palëve për projekte dhe plane që mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative përtej kufijve shtetërorë.

### 2.5.3. PROTOKOLLI I KIEVIT

Protokolli i Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor i miratuar më 2003, konsiderohet një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për vlerësimin e planeve dhe programeve strategjike. Ai kërkon që VSM-ja të realizohet në faza të hershme të procesit vendimmarrës dhe thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së gjerë publike. Protokolli zbatohet për plane dhe programe në sektorë të ndryshëm zhvillimorë, përfshirë planifikimin hapësinor dhe shfrytëzimin e tokës, duke qenë plotësisht i aplikueshëm për Planin Zhvillimor të Komunës së Vushtrisë.

## 2.6. HISTORIKU LEGJISLATIV DHE ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE

### 2.6.1. LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Ligji për Planifikimin Hapësinor rregullon çështjet që lidhen me planifikimin hapësinor dhe urban në Kosovë dhe synon mbrojtjen e burimeve natyrore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshirjen e publikut në proceset planifikuese. Sipas këtij ligji, ekzistojnë dy nivele të planifikimit – qendror dhe lokal – ndërsa Plani Zhvillimor Komunal është dokumenti kryesor multisektorial që përcakton objektivat afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor të komunës. Për çdo plan të këtij niveli është i detyrueshëm përgatitja e raportit të VSM-së paralelisht me hartimin e planit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është institucioni përgjegjës për koordinimin e planifikimit hapësinor në nivel kombëtar, ndërsa autoritetet lokale, përfshirë Komunën e Vushtrrisë, janë përgjegjëse për zbatimin e planeve dhe zhvillimeve urbane në përputhje me politikat dhe legjislacionin në fuqi.

### 2.6.2. LIGJI PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR

Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor përcakton obligimin për integrimin e çështjeve mjedisore në përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve që mund të kenë ndikime të rëndësishme në mjedis. Asnjë plan i tillë nuk mund të miratohet pa raportin përkatës të VSM-së. Ligji gjithashtu përcakton procedurat për konsultim publik, shqyrtim institucional, monitorim dhe raportim, si dhe kriteret për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve mjedisore.

### 2.6.3. PLANE DHE PROGRAME TË TJERA RELEVANTE

Në përgatitjen e VSM-së për Planin Zhvillimor të Komunës së Vushtrrisë janë marrë parasysh edhe dokumente të tjera strategjike dhe planifikuese, përfshirë Planin Hapësinor të Kosovës, Strategjinë për Mjedisin dhe Planin e Veprimit për Mjedisin, si dhe plane dhe programe të tjera sektoriale të hartuara nga institucionet relevante në nivel kombëtar dhe lokal.

### 3. METODOLOGJIA E PUNËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL

#### 3.1. QASJA METODOLOGJIKE E PËRGJITHSHME

Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal është realizuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Republikës së Kosovës për VSM dhe udhëzimet e Direktivës së Bashkimit Evropian 2001/42/EC. Metodologjia bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, integritit të çështjeve mjedisore në planifikimin hapësinor dhe parandalimit të ndikimeve negative në mjedis që në fazat e hershme të planifikimit.

#### 3.2. FAZA E PËRCAKTIMIT TË FUSHËVEPRIMIT

Në fazën fillestare është përcaktuar fushëveprimi i VSM-së, duke identifikuar temat kryesore mjedisore dhe aspektet që ndikohen nga Planin Zhvillimor Komunal, përfshirë:

- Biodiversitetin, florën dhe faunën,
- Tokën dhe përdorimin e tokës,
- Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore,
- Ajrin dhe ndryshimet klimatike,
- Mbeturinat dhe ndotjen,
- Shëndetin e njeriut,
- Trashëgiminë kulturore dhe peizazhin.

Kjo fazë është realizuar në konsultim me autoritetet kompetente mjedisore dhe institucionet përkatëse.

#### 3.3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE TË MJEDISIT

Është bërë analiza e gjendjes aktuale të mjedisit në territorin e komunës, duke u bazuar në:

- Dokumentet strategjike dhe planifikuese ekzistuese,
- Të dhënat statistikore dhe raportet institucionale,
- Studimet mjedisore dhe sektorale,
- Të dhënat hapësinore (GIS) dhe hartat tematike.

Kjo analizë ka shërbyer për identifikimin e problemeve kryesore mjedisore dhe zonave me ndjeshmëri të veçantë.

#### 3.4. IDENTIFIKIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE DHE TREGUESVE

Janë përcaktuar objektivat mjedisore strategjike në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe treguesit për monitorimin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal. Objektivat synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin racional të burimeve natyrore dhe rritjen e cilësisë së jetës së popullsisë.

#### 3.5. VLERËSIMI I ALTERNATIVAVE DHE SKENARËVE TË ZHVILLIMIT

Janë analizuar skenarët dhe konceptet e zhvillimit hapësinor të propozuara në Planin Zhvillimor Komunal. Secili skenar është vlerësuar në aspektin e ndikimeve të mundshme mjedisore, duke identifikuar avantazhet, kufizimet dhe rreziqet mjedisore.

### 3.6. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

Është kryer vlerësimi cilësor dhe, aty ku ishte e mundur, sasior i ndikimeve të Planit në mjedis. Janë identifikuar ndikimet pozitive dhe negative, direkte dhe indirekte, afatshkurtra dhe afatgjata, kumulative dhe sinergjike.

### 3.7. MASAT E MITIGIMIT DHE REKOMANDIMET MJEDISORE

Për ndikimet negative të identifikuar janë propozuar masa parandaluese dhe lehtësuese (mitigim), duke përfshirë:

- Masa planifikuese dhe rregullatore,
- Masa teknike dhe inxhinierike,
- Masa institucionale dhe menaxheriale.

Gjithashtu janë dhënë rekomandime për integrimin e çështjeve mjedisore në dokumentet e planifikimit dhe zbatimit.

### 3.8. KONSULTIMI PUBLIK DHE INSTITUCIONAL

Procesi i VSM-së ka përfshirë konsultime me institucionet relevante, palët e interesit dhe publikun, në përputhje me kërkesat ligjore për transparencë dhe pjesëmarrje publike. Komentet dhe sugjerimet e marra janë reflektuar në dokumentin final.

### 3.9. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Janë përcaktuar mekanizmat për monitorimin e zbatimit të Planit dhe ndikimeve mjedisore, duke përfshirë treguesit mjedisorë, institucionet përgjegjëse dhe frekuencën e raportimit. Monitorimi synon sigurimin e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore të Planit.

### 3.10. KUFIZIMET E METODOLOGJISË

Metodologjia është bazuar në të dhënat ekzistuese dhe burimet e disponueshme. Disa kufizime lidhen me mungesën e të dhënave të detajuara lokale dhe pasiguritë në parashikimet afatgjata, veçanërisht lidhur me ndryshimet klimatike dhe zhvillimet socio-ekonomike.

## 4. ANALIZA E GJENDJËS EKZISTUESE

### 4.1. VEÇORITË MJEDISORE

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veri-lindore të Republikës së Kosovës dhe përfshin një sipërfaqe prej rreth 345 km<sup>2</sup>. Gjatësia e territorit të saj nga veriu në jug është rreth 34 km, ndërsa nga lindja në perëndim rreth 23 km. Komuna kufizohet me Mitrovicën në veri, Podujevën në lindje, Obiliqin në jug, Drenasin në jugperëndim dhe Skenderajin në perëndim. Në përbërje të saj administrative janë 67 fshatra.

Nga aspekti gjeografik, Vushtrria zë rreth 3.2% të territorit të përgjithshëm të Kosovës dhe shtrihet në pjesën veriore të Rrafshit të Kosovës, një nga dy njësitë kryesore rrafshnalte të vendit. Pozita e saj gjeografike ka qenë historikisht shumë e favorshme, pasi në këtë zonë kryqëzoheshin rrugë të rëndësishme antike dhe mesjetare, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin urban, ekonomik dhe shoqëror të qytetit dhe rajonit përreth.

Dy rrugët kryesore historike që përshkonin këtë territor ishin aksi veri-lindje – jug-perëndim Naissus–Lissus (Nish–Lezhë) dhe aksi veri-perëndim – jug-lindje që lidhte Bosnjën me Maqedoninë e Veriut. Sipas burimeve historike, këto rrugë kalonin përmes territorit të sotëm të Vushtrrisë, duke e bërë këtë zonë një nyje të rëndësishme komunikimi. Aktualisht, autostrada Prishtinë–Mitrovicë kalon nëpër territorin e komunës dhe lidh rajonin verior të Kosovës me pjesën qendrore dhe lindore të vendit.

Elementi kryesor hidrografik i komunës është lumi Sitnica, i cili është lumi më i madh që përshkon territorin e Vushtrrisë. Sitnica është lumi i dytë më i madh në pellgun natyror të Kosovës, pas Drinit të Bardhë, me një sipërfaqe pellgu prej rreth 2,912 km<sup>2</sup>. Ai grumbullon ujërat e disa lumenjve dhe përrenjve më të vegjël, si Llapi, Lumkuqi, Tërstena dhe rrjedha të tjera ujore që vijnë nga shpatet lindore të malit Çyçavica.

Nga aspekti i cilësisë së ujit, lumi Sitnica klasifikohet në kategorinë e katërt të ndotjes, që përfshin lumenjtë më të ndotur në Kosovë. Përveç ndotjes kimike, lumi është i ekspozuar ndaj ndotjeve industriale dhe urbane, përfshirë praninë e fenoleve dhe ujërave të papërpunuara, gjë që paraqet një problem serioz mjedisor dhe shëndetësor për komunën.

### 4.2. PEDOLOGJIA – PËRMBAJTJA E DHERAVE DHE GJEOLGJIA

Përbërja pedologjike e mbulesës së shkrihtë tokësore është rezultat i bashkëveprimit të ndërsjellë të substratit gjeologjik, kushteve klimatike, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe botës organike. Ndryshimet horizontale dhe në lartësi të substratit pedogjen, kushteve klimatike dhe bimësisë, kanë kushtëzuar krijimin e tipeve dhe varieteteve të ndryshme të tokave në territorin e komunës së Vushtrrisë. Tokat në këtë komunë janë mjaft heterogjene nga aspekti i krijimit, vetive fiziko-kimike, përkatësisë tipologjike, pjellorisë potenciale, problemeve melioruese etj.

Në territorin e Vushtrrisë shtrirje më të madhe kanë tokat aluviale, smonica livadhore, gështenjë një argjilet liqenore, gështenjë të kaftë në shkëmbinj kompakt, tokat e cekëta skeletoide etj. Tokat aluviale rreth lumit Sitnica, përkundër ndryshimeve fizike dhe kimike, cilësohen si toka me vlerë të madhe bujqësore. Sipas bonitetit, tokat e territorit të Vushtrrisë u takojnë klasave të ndryshme.

- Tokat e klasës së I-rë kanë shtrirje të kufizuara, kryesisht në anën e djathtë të lumit Sitnica, prej pjesës veriore të vendbanimit Breglum, deri në veri të fshatit Rrafshmir, pastaj rreth grykëderdhjes së lumit Llap.




- Tokat e klasës të II-të përfshijnë tërë pjesën e ulët të territorit të komunës së Vushtrrisë.
- Përhapje mjaft të madhe kanë edhe tokat e klasës së III-të, që shtrihen në terrenet bregorokodrinore në pjesën juglindore të komunës, si dhe një zonë të ngushtë në pjesët e ulëta të shpatijeve lindore të Qyqavicës.
- Tokat e klasës së IV-të kanë shtrirje të kufizuar në shpatet e Qyqavicës.
- Tokat e klasës së V-të kryesisht shtrihen në pjesën verilindore të territorit të komunës (Shala e Bajgorës) dhe në sipërfaqe të kufizuara në pjesët më të larta të Qyqavicës.

Ndërtimi gjeologjik i komunës së Vushtrrisë i takon Fushëgropës së Kosovës, e cila është krijuar gjatë rrudhosjes së oligomiocenit. Me proceset e shkarjes dhe fundosjes së fushëgropës ndërlidhen erupcionet dacidoandezike në pjesët periferike të saj. Formacionet liqenore të policenit kanë përhapje të madhe në territorin e Vushtrrisë. Ato përfshijnë terrene bregore në të dy anët e rrafshit të Sitnicës, mbi sedimentet e policenit shtrihen formacionet e kuaternarit, të cilat përbëhen kryesisht nga sedimentet lumore të Sitnicës dhe rrjedhjeve të poshtme të degëve të saj, siç janë:


- Lymi,
- Rëra,
- Zhavorri,
- Argjila etj.

Në bazë të hartës gjeologjike, përhapje më të madhe kanë shkëmbinjtë:

- Brekqe dhe tufa vullkanike,
- Shkëmbinj ultrabazik,
- Bazik,
- Policen i pandarë,
- Mermer etj.



Harta 1 Karakteristikat gjeologjike të komunës së Vushtrrisë



Harta 2 Formacionet pedologjike të komunës së Vushtrrisë

### 4.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE

Territori i komunës së Vushtrrisë ka një rrjet hidrografik të zhvilluar, që i përket në tërësi ujëmbledhësit të Detit të Zi (Sitnicë, Ibër). Nëpër këtë territor rrjedh lumi Sitnica dhe degët e tij, si dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë (4314 km<sup>2</sup>), Sitnica është lumi i dytë më i madh në Kosovë në terma të sipërfaqes së ujëmbledhësit, me 2912 km<sup>2</sup>. Komuna e Vushtrrisë mbulon rreth 345 km<sup>2</sup>, që përfaqëson afërsisht 12% të sipërfaqes totale të ujëmbledhësit të lumit Sitnica, duke shërbyer si pikë kyçe hidrometrike për këtë ujëmbledhës.

Në sektorin që kalon përmes territorit të Vushtrrisë, lumi Sitnica merr disa degë kryesore nga ana e djathtë, si: Llapi, Lumkuqi, Tërstena, dhe Banja e Gjytezës, ndërsa nga ana e majtë merr disa përrenj dhe përrocka periodike, që formohen në shpatet lindore të Qyqavicës. Po ashtu, në këtë territor kalojnë dy lumenj të vegjël: Tërstena dhe Studimja.


Territori i Vushtrrisë është i përbërë kryesisht nga tri komplekse shkëmbinjsh me veti të ndryshme hidrogeologjike dhe aftësi për grumbullimin e ujërave nëntokësore (akuiferë):

- Kompleksi i shkëmbinjve kompaktë
- Kompleksi i shkëmbinjve plastikë, kompaktë dhe të shkriftë
- Kompleksi i shkëmbinjve të shkriftë


Nga pikëpamja hidrogeologjike, territori i komunës së Vushtrrisë ka veti të dobëta filtruese, mungesë horizontesh ujëmbajtës me kapacitete të mëdha eksploatueshëm, dhe ujëdhënie të ulët. Komuna ka lumenj që rrjedhin gjatë gjithë vitit dhe lumenj që rrjedhin vetëm kur ka reshje shiu. Këta lumenj janë:

- Sitnica
- Llapi
- Breznica
- Lumkuqi
- Studimja
- Podranqa
- Tërstena
- Bajska
- Smrekonica

Të gjithë këta lumenj burimin e kanë në Bjeshkët e Shalës, përveç lumit Llap, i cili ka burimin në bjeshkët e Llapit, dhe lumit Sitnica, që rrjedh nga Rrafshi i Kosovës dhe bjeshkët e Qyqavicës. Të gjithë lumenjtë, përveç Sitnicës, rrjedhin nga ana e djathtë e rrugës magjistrale Prishtinë – Vushtrri – Mitrovicë dhe lumit Sitnica, ndërsa nga ana e majtë shtrihen bjeshkët e Qyqavicës, ku nuk ka lumenj me rrjedhje të përherëshme, por ka përrenj dhe përrocka që varen nga kushte atmosferike. Po ashtu, në fshatin Taraxhë ndodhen dy liqej, të cilët gjatë periudhës së verës, sidomos në temperaturat e larta, mund të thahen, por pjesën më të madhe të vitit mbajnë ujë.



Harta 3 Rjeti hidrografik i komunës së Vushtrrisë




Harta 4 Harta hidrogeologjike e komunës së Vushtrrisë

#### 4.4. LARTËSIA MBIDETARE

Komuna e Vushtrrisë ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës dhe shtrihet në një lartësi mbidetare prej rreth 500 metrash.

Territori i komunës përfshin 345 km<sup>2</sup> dhe përbëhet nga qyteti i Vushtrrisë si qendër urbane dhe 66 fshatra.

Relievi i komunës karakterizohet nga një kombinim i fushave dhe kodrinave. Pjesa më kodrinore e komunës është kryesisht në anët lindore dhe perëndimore. Malet në Komunën e Vushtrrisë janë në pjesën jugore të Kopaonikut dhe në anën lindore të Qyqavicës. Malet e Qyqavicës shtrihen në anën perëndimore të qytetit, me një pikë më të lartë prej 1,091 metrash.



Harta 5 Hipsometria e terrenit të komunës së Vushtrrisë

## 4.5. PJERTËSIA E SHPATIEVE

Pjerrtësia e shpatijeve në komunën e Vushtrrisë varion në varësi të zonës specifike. Në zonat kodrinore dhe malore, shpatijet kanë pjerrësi më të theksuar, ndërsa në fushat dhe luginat, terreni është më i rrafshët. Këto variacione në pjerrësi ndikojnë në përdorimin e tokës, bujqësinë dhe zhvillimin urban të komunës.


### 4.5.1. ZONAT ME PJERRËSI TË ULËT

Këto përfshijnë fushat dhe zonat e ulëta rreth lumit Sitnica, ku pjerrësia zakonisht është më pak se 5%. Përdorimi kryesor i këtyre tokave është bujqësor, duke përfshirë prodhimin e grurit, misrit dhe kulturave të tjera bujqësore. Zonat me pjerrësi mesatare: Në pjesët kodrinore, pjerrësia varion nga 5% deri në 15%. Këto zona përdoren për bujqësi të përzier dhe bagëti, ndërsa një pjesë e tyre janë të mbuluara me pyje dhe bimësi natyrore.

### 4.5.2. ZONAT ME PJERRËSI TË THEKSUAR:

Malet e Kopaonikut dhe shpatijet e Qyqavicës kanë pjerrësi mbi 15%, dhe në disa vende arrijnë deri në 30%. Këto zona janë më pak të përshtatshme për bujqësi intensive, por ofrojnë mundësi për pylltari, kullota dhe aktivitete rekreative.

Roli i pjerrtësisë së shpatijeve në komunën e Vushtrrisë është shumëdimensional. Ndikon në përdorimin e tokës, zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen mjedisore. Njohja dhe menaxhimi i duhur i këtyre karakteristikave është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës. Integrimi i këtyre faktorëve në planifikimin hapësinor mund të ndihmojë në maksimizimin e përfitimeve nga territori dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Kujdesi ndaj këtyre zonave mund të përmirësojë cilësinë e jetës për banorët, duke mbrojtur njëkohësisht mjedisin dhe resurset natyrore.



Harta 6 Pjerrtësia e terrenit në komunën e Vushtrrisë

#### 4.6. KUSHTET KLIMATIKE

Komuna e Vushtrrisë gjendet gati në qendër të brezit të mesëm verior termik, prandaj klima është e butë, kontinentale mesdhetare dhe kontinentale evropiane. Ky territor karakterizohet me dimra të ftohtë dhe verëra të nxehta, me sasi të madhe të reshjeve dhe thatësi më të madhe gjatë verës dhe dimrit. Ndryshimet në lartësi mbidetare janë të buta.

Temperatura e ajrit është e ndryshueshme. Vlera mesatare vjetore është 10.2°C, muaji më i ftohtë është Janari me -1.5°C, përderisa muaji më i nxehtë është Gushti me temperaturë mesatare vjetore në 20.5°C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9°C, ku me vlerat ekstreme dhe me elementet tjera krijojnë klimën e regjimit kalimtar në mes të klimës mesatare kontinentale të ashpër malore, kur vjeshta është më e nxehtë se pranvera për 1.5°C.

Sipas ecurive vjetore të lagështisë relative të ajrit, për regjionin e Vushtrrisë, mund të konstatohet se pjesa prej prillit deri në gusht (68.1-72.8%) ka ajër me vlerë të lagështisë relative të thatë, kurse muajt e tjerë kanë vlerë të lagështisë relative të ajrit mesatarisht të lagësht (75 – 87.2%). Vlera mesatare vjetore e lagështisë relative është 72.2%.

Në regjimin e reshjeve atmosferike të territorit dhe rrethinës, ndikim parësor kanë aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku, ndërsa ato të nxehtat nga Jugu nga hapësira Mesdhetare, si dhe ato që depërtojnë gjatë dimrit si masa të ftohta të ajrit që vijnë nga Veriu dhe Veri-Lindja. Sasia e reshjeve ndryshon nga 670 - 810 mm. Në ecuritë mujore gjatë vitit, reshjet nuk kanë lëkundje të mëdha. Stinët me më së shumti reshje janë: vjeshta (173 mm) dhe vera (160mm), ndërsa me më së paku është dimri (126mm) dhe pranvera (150mm). Sasia e reshjeve rritet me rritjen e lartësisë mbidetare prej 700 – 850mm. Sipas veçorive të regjimit pluviometrik (shpërndarjes së reshjeve gjatë vitit), territori i Vushtrrisë ka veti më të shprehura të regjimit kontinental.

Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre mund të konstatohet se periudhat e qetësisë lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe temperaturës me 32.7%. Prej erërave dominon era frontale, në veri-verilindje me 20.3%, nga veriu me 19.4% dhe ajo që lajmërohet më pak është era në drejtim të lindjes me 4%, dhe nga jugu me 5%. Era nga drejtimi Verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin Gusht e më së paku në muajin Prill. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit Mars në shumë vite dhe ka vlerën 3.2 m/s, ndërsa më e vogla në muajin Shtator 1.8 m/s.

Muajt me më së shumti vranësira janë: Dhejtori (7.2), Janari (7.0), Shkurti dhe Nëntori që kanë vlerë të njëjtë (6.4), kurse vlerat minimale të vranësirave paraqiten në Gusht (3.1) dhe Korrik (3.8). Vlera mesatare vjetore e vranësisë është 5.4, të dhjetat e qiellit të mbuluar me re.

## 4.7. BIOGEOGRAFIA DHE BIODIVERSITETI

### 4.7.1. FLORA

Vushtrria si komunë, në shtrirjen e saj territoriale ka dy komplekse ose masive pyjore:

- Kompleksi pyjor (Sllakovc – Vesekovc që shtrihet në pjesën veri-lindore të komunës në një sipërfaqe prej 4938,40 hektarë).
- Kompleksi i Qyqavicës që shtrihet në pjesën jug – perëndimore të komunës dhe përfshin një sipërfaqe prej 2,237 hektarë.

Deri sa kemi një larmi të përhapjes së bimëve në masivin pyjor të kësaj komune në anën tjetër gjendja e këtyre pyjeve nuk është aspak e mirë. Nga gjithsej 7174,50 hektarë sa është sipërfaqja disponuese me pyje në sektorin shtetëror, toka të mbuluara me pyje janë 5278,10 ha, apo 73,50% të sipërfaqes, ndërsa pjesa tjetër prej 1896,40 ha, apo 26,50% janë toka të pa mbuluara me pyje. Përveç kësaj edhe struktura e fondit pyjor ekzistues nuk është e mire. Nga e gjithë sipërfaqja me pyje, kultura pyjore (halorë) janë 189,40 hektarë apo shprehur në përqindje 3.60% të kësaj sipërfaqe, pyje të larta janë 296.00 ha apo 5.40% të sipërfaqes, ndërsa pjesa më e madhe prej 4792,70 ha apo 91.00% të sipërfaqes së pyjeve janë pyje të ultë.

Në sektorin privat janë 5987 ha sipërfaqe me pyje që përbëhen kryesisht nga pyje të ahut dhe dushqeve dhe që gjendja e tyre është më e mirë se e atyre në sektorin shoqëror. Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë në fushën e mbrojtjes së pyjeve që ka mbretëruar para dhe pas luftës, gjendja e pyjeve tashmë është gati alarmante.

Aktivitetet që duhet të merren për kultivimin e pyjeve të larta dhe pyllëzimit të sipërfaqeve të zhveshura janë:

- Zvogëlimi i shkallës së prerjes së pakontrolluar dhe të pa planifikuar të pyjeve.
- Pyllëzimi i pyjeve të asgjësuara dhe sipërfaqeve të zhveshura
- Rritje të nivelit dhe efikasitetit në kontroll
- Përkujdesja më e madhe në ruajtjen e sipërfaqeve të po sa pyllëzuara
- Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara ha/në vit

Territori i komunës së Vushtrrisë zë një vend të rëndësishëm në Kosovë për nga aspekti floristik dhe vegetativ. Sipas të dhënave që disponojmë, territori i komunës së Vushtrrisë i takon Rajonit Eurosiberiko – Amerikanoverior i cili përfshin viset kontinentale të vendit, e që ndahen ndërmjet rajoneve kufitare mediterane nga njëra anë dhe majave më të larta të masiveve malore të cilat i takojnë regjionit Alpiko – Nordik nga ana tjetër. Ky regjion i Vushtrrisë, prezentohet me dy provinca fitogjeografike:

1. Provinca Mezike, e cila përfshin shpatet e Malit të Qyqavicës dhe Kopaonikut në kuadër të së cilës hyjnë pyjet lëvorbardha dhe pyjet lëvorzeza të brezit malor (montan) dhe paramalor (submontan) e që në këtë territor paraqitet konkretisht me pyje të bungut dhe shkozës (Querco – Carpinetum Rud.) dhe pyjet kodrinore dhe malore të ahut (Fagetum montanum Rud.);
2. Provinca Mezike, brez më i ulët ku përfaqësohet me Aleancën Quercion frainetto Ht. 1954. Kjo provincë përfshin pjesën më të madhe të territorit të Vushtrrisë. Nëse e vështrojmë realisht kësaj province i takon:

- E tërë sipërfaqja bujqësore, e cila dikur i ka takuar bashkësive pyjore të qarrit e që më vonë në vazhdimësi është shëndrruar në sipërfaqe bujqësore, si dhe
- Sipërfaqet kodrinore të shpateve të Qyqavicës nga ana jugperëndimore dhe Kopaonikut nga ana veri – lindore.

Në bazë të kësaj që u përmend më lart, mund të konstatohet se në territorin e komunës së Vushtrrisë janë zhvilluar pyjet gjetherënëse, termofile dhe mezofile; të prezentuara në bashkësi të ndryshme të cilat ndërmjet tyre dallohen në bazë të përbërjes floristike si pasojë e kushteve të ndryshme ekologjike.

Në territorin e Vushtrrisë janë prezente këto bashkësi (asociacione) pyjore:

- Ass. *Carpinetum orientalis scardicum*, Krasniqi (Bashkësia e shkozë së zezë);
- Ass. *Quercetum farnetto – cerris scardicum*, Krasniqi (Bashkësia e shpardhit dhe qarrit), e përhapur kryesisht në lartësi mbidetare deri në 750 m;
- Ass. *Quercetum montanum*, Çer. et Jov. (Bashkësia e dushkut malor), në lartësi mbidetare prej 630 – 960 m, e përfaqësuar kryesisht nga bunga (*Quercus petraea*);
- Ass. *Fagetum montanum Rud.* (Bashkësia e ahut), në pjesët e larta të degëve të Kopaonikut, ndërsa në Qyqavicë është degraduar në shkallë alarmante.

Në bazë të kësaj pasqyre floristike dhe vegjetative të territorit të Vushtrrisë mund të konstatohet se:


- Territori i Vushtrrisë posedon florë dhe vegjetacion relativisht të mirë, mirëpo në degradim e sipër, si pasojë e veprimit negativ të faktorit antropogjen (sidomos në hapësirat rreth vendbanimeve) dhe
- Në shumë lokalitete të territorit do të ishte mirë të bëhen intervenime pozitive drejtë normalizimit të gjendjes natyrore përmes pyllëzimit me llojet adekuate.

Ndryshimet e ndërlikuara dhe të mëdha karakterizojnë faunën në territorin e Vushtrrisë, të cilat me intensitet të shtuar vazhduan për një kohë relativisht të gjatë, duke çuar në shndërrimin e hapësirës natyrore në territor agrikor, industrial, territor për banim etj. Si rezultat i këtyre veprimeve disa lloje shtazore të cilat kanë ekzistuar në këto terrene janë zhdukur ose zhduken. Lloje të cilat janë zhdukur kohë më parë nga këto terrene janë:

- Dreri,
- Dhia e egër,
- Ariu,
- Luqerbulli,
- Gjelegri etj.

Llojet prezente janë më rezistente ndaj kushteve të ofruara apo të imponuara por edhe te këto lloje vërehet zvogëlimi i numrit të tyre. Llojet të cilat ende hasen në territorin e Vushtrrisë janë: ujku (*Canis lupus*), dhelpra (*Vulpis vulpis*), qelbësi i rëndomtë, derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), ketri (*Sciurus vulgaris*), sqarthi (*Martes foina*), vidra, lepuri (*Oryctolagus cuniculus*), disa lloje të brejtësve të

vegjël, gjerajqina, skifteri i përhimtë, petriti (*Falco tinnunculus*), kukuvajka, huti (*Bubo bubo*), harabeli, thëllënza (*Alectoris graeca*), pëllumbi i egër, kumria, disa lloje të korbave, çukapiku (*Dendrocopus major*), qyqja (*Cuculus canorus*), lauresha, borësi, rosat e egra (*Anser anser*), patat e egra (*Anas platyrhynchos*), lejlekët (lloje kalimtare dhe hasen rrallë), breshka e kënetave, breshka e pyjeve, hardhuca e përhimte, hardhuca e mureve, hardhuca e gjelbër, neperka, gjarpëri i larmë, gjarpëri i ujit (*johelmues*), picrraku (*Salamandra atra*), tritoni (*Triturus vulgaris*), bretkosa e gjelbërt, bretkosa dregëzore, krapi (*Cyprinus caprio*), fildishi, skobusi, shumë lloje të pakurrizorëve etj.



Harta 7 Vlera e llogaritur e biodiversitetit

## 4.8. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

### 4.8.1. FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM (UJËSJELLËSI)

Furnizimi me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë realizohet kryesisht përmes Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica”, e cila përdor burimet e sistemit rajonal Ibër–Lepenc dhe Liqenin e Ujmanit. Trajtimi dhe filtrimi i ujit kryhet në impiantin qendror në Mitrovicë, i cili është zgjeruar për të rritur kapacitetin e furnizimit rajonal. Rrjeti primar i ujësjellësit shtrihet përgjatë boshtit jug–veri të komunës, ndërsa furnizimi lokal realizohet përmes rezervuarëve dhe rrjetit shpërndarës në qytet dhe disa vendbanime rurale.

Megjithatë, furnizimi me ujë përballet me sfida të konsiderueshme, sidomos në vendbanimet me lartësi më të mëdha dhe në zonat periferike rurale, ku presioni i ujit është i pamjaftueshëm dhe ndërprerjet janë të shpeshta gjatë sezonit veror. Një pjesë e popullsisë nuk është e kyçur në rrjetin publik dhe mbështetet në puse individuale ose burime lokale, gjë që paraqet rrezik për sigurinë e furnizimit dhe cilësinë e ujit.

Incidenti i ndërprerjes së furnizimit në nëntor 2024, si pasojë e problemeve në kanalin Ibër–Lepenc, ka theksuar varësinë e sistemit nga një burim i vetëm dhe nevojën për kapacitete rezervë, përfshirë ndërtimin e rezervuarëve shtesë dhe rehabilitimin e rrjetit ekzistues. Përmirësimi i kapaciteteve të furnizimit dhe rritja e presionit në rrjet mbeten prioritet kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe rural.

Impianti i përpunimit të ujit në Balincë përbën nyjen kryesore të trajtimit të ujit për komunën dhe ka kapacitet të projektuar të konsiderueshëm, por aktualisht funksionon me kapacitet të reduktuar. Procesi i trajtimit përfshin filtrimin, dezinfektimin dhe ruajtjen e ujit, duke garantuar standardet e cilësisë për konsum njerëzor.

Në territorin e komunës janë të vendosur disa rezervuarë dhe stacione pompimi që sigurojnë akumulimin dhe shpërndarjen e ujit në zona të ndryshme. Megjithatë, një pjesë e këtyre objekteve janë jashtë funksionit ose kërkojnë rehabilitim, duke kufizuar qëndrueshmërinë e sistemit të furnizimit.

Rrjeti i ujësjellësit është i gjerë dhe i përbërë nga tubacione me materiale të ndryshme, ku dominon polietileni dhe PVC, ndërsa tubacionet e vjetra nga azbest-çimento dhe materiale të amortizuara paraqesin rrezik potencial për shëndetin publik dhe humbje teknike të ujit. Këto segmente kërkojnë zëvendësim gradual sipas planit të menaxhimit të aseteve.

Cilësia e ujit monitorohet në përputhje me Udhëzimin Administrativ për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Monitorimi laboratorik përfshin parametra fizikë, kimikë dhe mikrobiologjikë, ndërsa niveli i përputhshmërisë raportohet në mënyrë periodike. Megjithatë, humbjet në rrjet dhe amortizimi i infrastrukturës mbeten sfida që ndikojnë në sigurinë afatgjatë të furnizimit.

#### 4.8.1.1. RRJETI I KANALIZIMIT DHE MENAXHIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

Sistemi i kanalizimit në Komunën e Vushtrrisë është pjesërisht i zhvilluar dhe kryesisht i ndërtuar gjatë periudhës 1970–1980. Rrjeti funksionon kryesisht në mënyrë gravitacionale dhe mbledh ujërat e ndotura fekale dhe atmosferike, të cilat aktualisht shkarkohen në lumenjtë lokalë për shkak të mungesës së impiantit të trajtimit, duke shkaktuar ndotje të vazhdueshme të mjedisit ujor dhe tokësor.

Në zonat rurale, menaxhimi i ujërave të ndotura realizohet kryesisht përmes gropave septike individuale, shpesh pa standarde teknike, gjë që paraqet rrezik për ndotjen e ujërave nëntokësore. Aktualisht është në zhvillim projekti ndër-komunal për ndërtimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Mitrovicë–Vushtrri, i cili do të përmirësojë ndjeshëm gjendjen mjedisore dhe përputhshmërinë me standardet e Bashkimit Evropian.

Rrjeti ekzistues përfshin kolektorë kryesorë dhe degë dytësore në zonën urbane, ndërsa mbulimi në zonat rurale mbetet i kufizuar. Sistemi i ndarë për ujërat atmosferike mungon pothuajse tërësisht, duke bërë që gjatë reshjeve intensive të ndodhin përmytje lokale dhe dëme infrastrukturore, veçanërisht në zona të ulëta dhe në vendbanime malore ku rrjedhjet sipërfaqësore janë të shpejta.

Materialet e përdorura në rrjetin e kanalizimit përfshijnë beton, polietilen, PVC dhe segmente të vjetruara nga azbest-çimento, të cilat paraqesin rrezik potencial për shëndetin dhe mjedisin dhe kërkojnë rehabilitim. Digjitalizimi i rrjetit dhe i pusetave është në proces, por ende nuk është i plotë për territorin e komunës.

#### 4.8.1.2. UJITJA E TOKAVE BUJQËSORE

Infrastruktura e ujitjes në Komunën e Vushtrrisë bazohet kryesisht në hidrosistemin rajonal “Ibër–Lepenc”, i cili përbën boshtin kryesor për vaditjen e tokave bujqësore në ultësirën e Sitnicës. Ky sistem përfshin kanalin kryesor, degëzime dytësore dhe stacione pompimi që mundësojnë ujitjen e qindra hektarëve tokë bujqësore.

Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e infrastrukturës sekondare është e degraduar dhe e pamirëmbajtur, duke kufizuar shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve ujitëse. Përveç sistemit rajonal, ekzistojnë edhe zgjidhje lokale si puse individuale dhe rezervuarë të vegjël, por këto janë të kufizuara dhe jo gjithmonë të qëndrueshme.

Ujitja konsiderohet një aset strategjik për zhvillimin bujqësor dhe sigurinë ushqimore, dhe rehabilitimi i sistemit ekzistues dhe zgjerimi i zonave të mbuluara përbëjnë prioritet për zhvillimin afatmesëm dhe afatgjatë.

#### 4.8.1.3. DRENAZHIMI DHE MBROJTJA NGA PËRMBYTJET

Rrjeti natyror i drenazhimit përbëhet nga lumenjtë Sitnica, Llushta dhe Drenica, si dhe nga përroskat malore që zbresin nga masivi i Çyqavicës. Mungesa e infrastrukturës së dedikuar për drenazhimin urban dhe rural bën që këto sisteme natyrore të jenë mekanizmi kryesor për largimin e ujërave atmosferikë.

Infrastruktura teknike për ujërat e shiut është shumë e kufizuar dhe përfshin vetëm segmente të vogla tubacionesh dhe kanale të hapura përgjatë rrugëve. Si pasojë, gjatë reshjeve intensive ndodhin përmytje lokale, erozion i tokës dhe dëme në infrastrukturë dhe toka bujqësore. Lumenjtë, veçanërisht Sitnica, kanë shkaktuar historikisht përmytje në zonat e ulëta fushore, ndërsa masat mbrojtëse janë të kufizuara.

Kanalet kulluese ekzistuese në zonat bujqësore janë pjesërisht të bllokuara dhe kërkojnë rehabilitim. Investimet e planifikuara synojnë ndërtimin e rrjeteve të reja atmosferike, rehabilitimin e kanaleve ekzistuese dhe vendosjen e strukturave mbrojtëse për reduktimin e rrezikut nga përmytjet.

#### 4.8.2. ENERGJIA ELEKTRIKE

Komuna e Vushtrrisë furnizohet me energji elektrike nga sistemi kombëtar i Kosovës, i cili bazohet kryesisht në prodhimin termik nga linjiti. Afërsia me termocentralet e Obiliqit ndikon në mjedisin lokal përmes ndotjes së ajrit dhe zënies së territorit për infrastrukturën transmetuese të tensionit të lartë. Në territorin e komunës kalojnë linja transmetuese dhe nënstacione që shërbejnë si për furnizimin lokal ashtu edhe për rrjetin kombëtar.

Infrastruktura elektroenergjetike përbën një komponent kyç për zhvillimin ekonomik dhe urban, por gjithashtu paraqet presione mjedisore për shkak të ndotjes, zënies së tokës dhe ndikimit vizual në peizazh.

#### 4.8.3. MENAXHIMI I MBETURINAVE – GJENDJA EKZISTUESE

Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrisë ofrohet nga KRM “Uniteti” sh.a., një ndërmarrje publike e licencuar për grumbullimin, transportin dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike. Shërbimi mbulon ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet publike, duke përfshirë mbledhjen e mbeturinave komunale nga kontejnerët publik dhe individual, dezinfektimin e pikave të grumbullimit dhe transportimin e mbeturinave drejt deponisë rajonale.

Rrjeti i shërbimit është i shtrirë në të gjitha vendbanimet e komunës, me grumbullim kolektiv në zonën qendrore urbane dhe grumbullim derë më derë në zonat rurale. Frekuenca e grumbullimit është e përditshme në zonën urbane, ndërsa në zonat rurale kryesisht një herë në javë. Sipas të dhënave të operatorit dhe komunës, shumica e konsumatorëve janë të përfshirë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, me mbulim të plotë të amvisërive dhe institucioneve publike, ndërsa bizneset mbeten pjesërisht jashtë sistemit.

Komuna ka hartuar Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2021–2026, në përputhje me Ligjin për Mbeturina, duke synuar përmirësimin e shërbimeve, rritjen e mbulimit dhe zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave.

Aktualisht, komuna nuk posedon stacione transferuese për grumbullimin e përkohshëm të mbeturinave. Të gjitha mbeturinat komunale transportohen dhe deponohen në deponinë rajonale “Gërmova” në Mitrovicë, e cila shërben edhe për komuna të tjera të rajonit. Transporti i mbeturinave përballet me sfida operative, përfshirë mungesën e mjeteve adekuate dhe ngarkesën e trafikut, duke ndikuar në efikasitetin e shërbimit dhe koston e përgjithshme të menaxhimit.

Sistemi i pikave të grumbullimit përbëhet nga kontejnerë me kapacitete të ndryshme, të vendosur përgjatë rrugëve dhe në lokacione të përbashkëta publike dhe private. Distancat ndërmjet pikave të grumbullimit ndryshojnë sipas densitetit të popullsisë, me dendësi më të lartë në zonën qendrore urbane. Gjendja fizike e kontejnerëve vlerësohet përgjithësisht e mirë, megjithëse evidentohen probleme me dëmtime mekanike dhe higjienë si pasojë e sjelljes së papërshtatshme qytetare.

Në territorin e komunës janë identifikuar deponi ilegale, kryesisht të përbëra nga mbetje inerte dhe të vëllimshme. Megjithëse disa prej tyre janë eliminuar gjatë viteve të fundit, një numër i konsiderueshëm mbetet aktiv, duke paraqitur rrezik për mjedisin, shëndetin publik dhe peizazhin.

Menaxhimi i rrymave të veçanta të mbeturinave paraqet sfida shtesë. Mbeturinat ndërtimore dhe inerte shpesh hidhen në mënyrë të pakontrolluar ose përzihen me mbeturinat komunale, duke ndikuar negativisht në sistemin ekzistues të grumbullimit. Komuna ka përcaktuar një lokacion për depozitimin e mbetjeve inerte, por zbatimi i rregulloreve mbetet i kufizuar. Mbetjet industriale dhe të rrezikshme, përfshirë mbetjet mjekësore dhe shtazore, trajtohen në mënyrë jo të integruar dhe në disa raste përfundojnë në deponinë komunale pa trajtim të veçantë, çka paraqet rrezik potencial për mjedisin dhe shëndetin e popullatës.

Aktivitetet e riciklimit dhe kompostimit janë në fazë fillestare dhe kryesisht realizohen nga sektorë joformal dhe biznese të vogla lokale. Ndarja e mbeturinave në burim nuk është e zhvilluar në mënyrë sistematike, megjithëse janë ndërmarrë disa iniciativa për shpërndarjen e shportave për riciklim dhe instalimin e

komposterëve në disa vendbanime rurale. Potenciali për kompostim vlerësohet i lartë, për shkak të strukturës rurale të popullsisë dhe sasisë së konsiderueshme të mbetjeve organike të gjeneruara nga aktivitetet bujqësore dhe familjare.

Në përgjithësi, sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë konsiderohet funksional, por me sfida të rëndësishme në aspektin e mbulimit të plotë të bizneseve, menaxhimit të mbetjeve të veçanta, eliminimit të deponive ilegale, zhvillimit të riciklimit dhe kompostimit, si dhe përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse dhe kapaciteteve operative.

#### **4.8.4. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM PËR VSM**

Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike në Komunën e Vushtrrisë karakterizohet nga mbulim i pjesshëm, amortizim i infrastrukturës ekzistuese dhe mungesë e sistemeve të ndara për menaxhimin e ujërave të ndotura dhe atmosferike. Furnizimi me ujë dhe energji elektrike është relativisht i qëndrueshëm në zonat urbane, por mbetet i kufizuar dhe jo i barabartë në zonat rurale. Kanalizimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura paraqesin një nga presionet kryesore mjedisore, ndërsa drenazhimi dhe mbrojtja nga përmbytjet janë sfida kritike për zhvillimin e qëndrueshëm hapësinor.

Ndërhyrjet e planifikuara në kuadër të PZHK-së dhe projekteve strategjike (si ITUN Mitrovicë–Vushtrri, rehabilitimi i rrjeteve ujore dhe investimet në drenazh) paraqesin masa kyçe për reduktimin e ndikimeve negative mjedisore dhe për harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian.

#### 4.9. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI PUBLIK


Transporti në Komunën e Vushtrrisë realizohet kryesisht përmes infrastrukturës rrugore, ndërsa transporti hekurudhor ekziston si potencial, por aktualisht nuk është funksional. Rrjeti rrugor përbëhet nga rrugë nacionale, rajonale dhe lokale, që sigurojnë lidhjen e komunës me qendrat kryesore urbane dhe vendbanimet përreth. Rruga nacionale N2 përbën korridorin kryesor të lëvizjes, duke lidhur Vushtrrinë me Prishtinën në jug-lindje dhe Mitrovicën në veri-perëndim, dhe shërben si bosht kryesor për qarkullimin e njerëzve dhe mallrave.

Përveç rrugës nacionale, komuna lidhet me komunat fqinje përmes rrugëve rajonale, të cilat sigurojnë qasje funksionale në Skenderaj, Podujevë dhe Obiliq. Rruga magjistrale Prishtinë–Vushtrri–Mitrovicë kalon nëpër një numër vendbanimesh, duke krijuar një korridor të rëndësishëm zhvillimor dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në shpërndarjen hapësinore të aktiviteteve ekonomike dhe urbane. Vendbanimet që gravitojnë drejt këtij korridori kanë qasje më të mirë në infrastrukturë rrugore dhe shërbime transporti, ndërsa vendbanimet periferike, veçanërisht në pjesët veriore, jugore dhe jugperëndimore të komunës, karakterizohen nga mungesa e rrugëve të asfaltuara dhe akses më i kufizuar në rrjetin kryesor.

Transporti publik urban dhe ndër-urban me autobus përbën një komponent të rëndësishëm të sistemit të transportit rrugor. Ky shërbim mbulon një pjesë të konsiderueshme të vendbanimeve dhe ofron akses të drejtpërdrejtë për një pjesë të madhe të popullsisë. Megjithatë, mbulimi hapësinor i transportit publik nuk është i njëtrajtshëm, me boshllëqe të dukshme në pjesën veriore të komunës dhe në disa vendbanime rurale periferike, ku qasja në shërbimet e transportit publik mbetet e kufizuar. Kjo situatë ndikon në mobilitetin e popullsisë, aksesin në shërbime publike dhe mundësitë socio-ekonomike.

Transporti hekurudhor paraqet një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të mobilitetit, por aktualisht infrastruktura hekurudhore është jofunksionale dhe në gjendje të amortizuar. Binarët hekurudhorë kalojnë nëpër pjesën qendrore të komunës dhe disa vendbanime, ndërsa stacionet ekzistuese janë jashtë funksionit dhe kërkojnë rehabilitim të plotë. Riaktivizimi i linjës hekurudhore dhe rinovimi i stacioneve do të mundësonte alternativa më të qëndrueshme të transportit, reduktim të presionit mbi transportin rrugor dhe përmirësim të lidhjes rajonale.

Në përgjithësi, infrastruktura e transportit në Komunën e Vushtrrisë konsiderohet funksionale, por me sfida të dukshme në aspektin e shpërndarjes së pabarabartë hapësinore, gjendjes së rrugëve lokale, mbulimit të transportit publik dhe mosfunksionalitetit të transportit hekurudhor. Këto faktorë kanë implikime të drejtpërdrejta mjedisore, sociale dhe ekonomike dhe duhet të adresohen në kuadër të planifikimit hapësinor dhe masave strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm të transportit.



Harta 8 Rrjeti i infrastrukturës rrugore

#### 4.10. SHËNDETËSIA


Shërbimet publike shëndetësore në Komunën e Vushtrisë ofrohen përmes një rrjeti institucional që përfshin shërbimin spitalor rajonal dhe shërbimin parësor të mjekësisë familjare, të organizuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendra të Mjekësisë Familjare dhe Ambulanta Mjekësore Familjare në vendbanimet rurale. Ky sistem siguron mbulim bazik shëndetësor për popullsinë urbane dhe rurale të komunës.

Spitali i Përgjithshëm Regional “Sheikh Zayed” në Vushtri përbën institucionin kryesor spitalor dhe ofron shërbime sekondare shëndetësore për komunën dhe rajonin përreth. Spitali është ndërtuar me donacion ndërkombëtar dhe ka kaluar nëpër faza të rinovimit dhe modernizimit, duke përmirësuar infrastrukturën dhe pajisjet mjekësore. Aktualisht spitali ka kapacitete të konsiderueshme shtretërorë dhe kuadër profesional në repartet e internës, pediatriisë, gjinekologjisë dhe maternitetit, kirurgjisë, kujdesit intensiv, radiologjisë, emergjencës, dermatologjisë, fiziatriisë, laboratorit dhe farmacisë spitalore.

Shërbimi i mjekësisë familjare organizohet përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe rrjetit të Qendrave Mjekësore Familjare të shpërndara në zonën urbane dhe rurale. Këto institucione ofrojnë shërbime parësore shëndetësore, diagnostike dhe preventive për popullsinë lokale. Infrastruktura e objekteve shëndetësore është e shpërndarë në mënyrë hapësinore në territorin e komunës, me sipërfaqe të ndërtuara dhe hapësira të lira që ofrojnë potencial për zgjerim të kapaciteteve në të ardhmen.

Ambulantat Mjekësore Familjare janë të vendosura në vendbanimet rurale dhe përbëjnë nivelin më të afërt të shërbimit shëndetësor për popullsinë rurale. Këto objekte kanë kapacitete bazike infrastrukturore dhe hapësira të mjaftueshme për zhvillim të mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore, duke kontribuar në rritjen e aksesit të popullsisë rurale në kujdesin shëndetësor parësor.

Në përgjithësi, sistemi shëndetësor në Komunën e Vushtrisë vlerësohet funksional dhe relativisht i shpërndarë mirë në aspektin hapësinor, megjithatë ekzistojnë sfida në aspektin e kapaciteteve të kuadrove, pajisjeve, aksesit të barabartë në shërbime për vendbanimet periferike dhe nevojës për modernizim të vazhdueshëm të infrastrukturës shëndetësore. Përmirësimi i sistemit shëndetësor është i lidhur drejtpërdrejt me cilësinë e jetës, mirëqenien sociale dhe qëndrueshmërinë mjedisore, veçanërisht në kontekstin e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit urban të komunës.



Harta 9 Shtirja e institucioneve publike shëndetësore

#### 4.11. INSTITUCIONET ARSIMORE

Sistemi arsimor në Komunën e Vushtrrisë përfshin institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe shkollat e mesme të larta. Infrastruktura arsimore ekzistuese përbëhet nga një numër i konsiderueshëm institucioneesh, të shpërndara në zonën urbane dhe rurale, me qëllim të sigurimit të qasjes së barabartë në arsim për popullsinë e komunës.

Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, një pjesë e konsiderueshme e institucioneve funksionojnë në një ndërrim, duke përmbushur kriteret e strategjive kombëtare për organizimin e mësimi. Megjithatë, në disa zona ende zhvillohet mësimi në dy ndërrime, gjë që tregon për kufizime në kapacitetet hapësinore dhe nevojën për zgjerim të infrastrukturës shkollore në të ardhmen.

Analiza e trendit të numrit të nxënësve tregon rënie të lehtë të numrit të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët gjatë periudhës së analizuar, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë vërehet një rritje e lehtë. Këto trende reflektojnë ndryshimet demografike, migrimin dhe ndryshimet socio-ekonomike në komunë. Në zonat rurale, shumë shkolla kanë numër të ulët të nxënësve për klasë, duke treguar për shfrytëzim joefikas të kapaciteteve ekzistuese dhe nevojën për racionalizim të rrjetit shkollor.


Gjendja fizike e ndërtesave arsimore ndryshon nga e mirë në të dobët, me disa institucione që kërkojnë rehabilitim, renovim ose rindërtim për të përmbushur standardet e sigurisë dhe funksionalitetit. Në veçanti, një numër i institucioneve parashkollore dhe shkollore në zona rurale dhe urbane janë në gjendje të dobët infrastrukturore, gjë që paraqet rrezik potencial për sigurinë e nxënësve dhe stafit.

Nga aspekti i planifikimit hapësinor, vlerësimi i sipërfaqeve të parcelave të destinuara për institucione arsimore tregon se ekziston mungesë e konsiderueshme e sipërfaqeve për institucionet parashkollore dhe të arsimit të mesëm të lartë, veçanërisht në zonën urbane. Ndërsa për institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, sipërfaqet ekzistuese përgjithësisht tejkalojnë kërkesat minimale, megjithatë shpërndarja hapësinore nuk është gjithmonë optimale, me mungesa në disa lagje urbane dhe pjesë rurale.

Vlerësimi i rrezes së mbulueshmërisë tregon se rrjeti i shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në përgjithësi plotëson kriteret e distancës shërbyese, ndërsa për institucionet parashkollore dhe të mesme të larta vërehen zona me mbulim të pamjaftueshëm, duke kërkuar planifikim të institucioneve të reja arsimore në të ardhmen.

Projeksionet demografike dhe trendet e regjistrimit të nxënësve tregojnë nevojë për planifikim afatgjatë të infrastrukturës arsimore, veçanërisht për institucionet parashkollore dhe të mesme të larta. Rritja ose ndryshimi i shpërndarjes së popullsisë pritet të ndikojë në kërkesën për hapësira arsimore, duke kërkuar integrim të planifikimit arsimor në Planin Zhvillimor Komunal dhe në masat e Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Në aspektin mjedisor, institucionet arsimore ndikojnë në përdorimin e tokës, gjenerimin e mbeturinave, konsumin e energjisë dhe ujit, si dhe në lëvizjet ditore të nxënësve dhe stafit, duke krijuar presion në mjedisin urban dhe infrastrukturën e transportit. Prandaj, zhvillimi i infrastrukturës arsimore duhet të integrohet me masa të qëndrueshme mjedisore, përfshirë efikasitetin energjetik, menaxhimin e mbetjeve dhe planifikimin e gjelbërimit në hapësirat shkollore.



Harta 10 Shtrirja e institucioneve publike arsimore

## 4.12. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

### 4.12.1. NDOTJA E AJRIT

Komuna e Vushtrrisë ndodhet midis zonave malore të Shalës dhe Çyqavicës dhe Rrafshit të Kosovës, duke u ndikuar drejtpërdrejt nga burime rajonale të ndotjes së ajrit, veçanërisht kompleksi xehetaro-metalurgjik “Trepça” në Mitrovicë dhe termocentralet e KEK-ut në Obiliq. Ndotësit kryesorë përfshijnë metalet e rënda (plumbi, zinku, bakri), gazrat toksikë (SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, CO<sub>2</sub>) dhe grimcat e pluhurit.

Ndikimi më i madh i ndotjes së ajrit vërehet në pjesën jugore të komunës, ku vendbanimet si Zhilivoda, Bivolaku, Prelluzha, Stanoci i Poshtëm dhe i Epërm, Graca dhe Strofc ekspozohen drejtpërdrejt ndaj emetimeve nga KEK-u. Në kushte të caktuara meteorologjike, veçanërisht gjatë erërave jugore, ndikimi shtrihet edhe në pjesët qendrore dhe veriore të komunës.

Burime tjera të ndotjes së ajrit përfshijnë aktivitetet e gurëthyesve, industrinë përpunuese (p.sh. fabrika e llamarinës), si dhe qarkullimin intensiv të automjeteve, veçanërisht në zonën urbane dhe përgjatë rrugëve magjistrale.

### 4.12.2. MONITORIMI I CILËSISË SË AJRIT

Komuna e Vushtrrisë nuk është pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe nuk disponon stacion monitorues lokal, çka kufizon ndjeshëm mundësitë për vlerësim të saktë të ndotjes. Vlerësimi i cilësisë së ajrit bazohet në të dhëna nga stacionet monitoruese rajonale në Obiliq dhe Mitrovicë.

Të dhënat tregojnë se vlerat vjetore të ndotësve zakonisht janë nën kufijtë ligjorë, por tejkalime sezonale janë regjistruar për grimcat PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>, veçanërisht gjatë muajve dimërorë. Këto tejkalime paraqesin rrezik për shëndetin publik dhe kërkojnë masa planifikuese për reduktimin e burimeve të ndotjes.

#### 4.12.3. NDOTJA E UJIT

Komuna e Vushtrrisë bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Sitnica, i cili konsiderohet një nga lumenjtë më të ndotur në Kosovë. Nëpër territorin e komunës rrjedhin lumenjtë Sitnica, Llapi, Tërstena dhe Studimja, si dhe një numër përrockash periodike.

Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore vjen kryesisht nga shkarkimet e patrajtuara të ujërave të zeza komunale dhe industriale, si dhe nga ndotësit rajonalë nga komunat fqinje dhe KEK-u. Në komunë mungon impianti për trajtimin e ujërave të zeza, dhe si pasojë të gjitha ujërat e ndotura shkarkohen direkt në lumenj.

Cilësia e ujit vlerësohet shumë e dobët në rrjedhën e poshtme të lumenjve pranë zonave të banuara, ndërsa në burime cilësia mbetet më e mirë. Mungesa e të dhënave zyrtare monitoruese kufizon vlerësimin e saktë të gjendjes, megjithatë analiza laboratorike e kryer në lumin Sitnica tregon prani të lartë të materieve organike, azotit dhe fosforit, duke sinjalizuar ndotje të konsiderueshme dhe presion antropogjen.

#### 4.12.4. NDOTJA E TOKËS

Toka në komunën e Vushtrrisë është kryesisht pjellore dhe me rëndësi të madhe bujqësore. Megjithatë, ajo përballet me presione të konsiderueshme nga degradimi i pyjeve, erozioni, aktivitetet minerare dhe nxjerrja e materialeve ndërtimore.

Prerjet ilegale të pyjeve dhe degradimi i sipërfaqeve pyjore, veçanërisht në zonën e Qyqavicës dhe Shalës, kontribuojnë në rritjen e erozionit dhe rrezikut nga vërshimet. Aktivitetet e paligjshme të nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit destabilizojnë shtretërit e lumenjve dhe rrisin rrezikun e përmytjeve, ndërsa guoret shkaktojnë ndotje me pluhur, zhurmë dhe degradim të peizazhit. Monitorimi i cilësisë së tokës kryhet nga institucionet qendrore dhe operatorët ekonomik, por deri më tani mungojnë testime sistematike për ndotësit prioritarë, metalet e rënda, pesticidet dhe hidrokarburet, çka paraqet boshllëk në vlerësimin e rrezikut mjedisor.

#### 4.12.5. NDOTJA AKUSTIKE

Ndotja akustike në komunë lidhet kryesisht me trafikun rrugor, aktivitetet industriale dhe guoret. Aktualisht nuk ekzistojnë matje sistematike të zhurmës dhe as rrjet monitorues, prandaj vlerësimi i gjendjes bazohet në vlerësime cilësore. Mungesa e të dhënave kufizon identifikimin e zonave kritike dhe planifikimin e masave të reduktimit të zhurmës.

#### 4.12.6. SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

##### 4.12.6.1. RRËSHQITJET DHE EROZIONI

Erozioni është një nga proceset kryesore degradative në territorin e komunës, me një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqes që vlerësohet me rrezikshmëri mesatare deri të lartë. Faktorët kryesorë përfshijnë përbërjen gjeologjike, reshjet, shfrytëzimin jo të qëndrueshëm të tokës dhe aktivitetet njerëzore.

Lokacionet me rrëshqitje të dheut janë evidentuar në disa vendbanime, ku reshjet intensive dhe përbërja e tokës kontribuojnë në paqëndrueshmëri të terrenit.



#### 4.12.6.2. TËRMETET

Komuna e Vushtrrisë ndodhet në zonë sizmike me intensitet mesatar, me potencial deri në shkallën 7–8 të shkallës MCS. Mungojnë studime të detajuara mikrosizmike, prandaj rreziku sizmik duhet të merret parasysh në planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve.

#### 4.12.6.3. VËRSHIMET

Vërshimet paraqesin një nga rreziqet kryesore natyrore, veçanërisht përgjatë lumenjve Sitnica, Llapi, Tërstena, Lumkuqi dhe Studimja. Faktorët kryesorë përfshijnë reshjet intensive, shtratin e pa mirëmbajtur të lumenjve, uzurpimet, nxjerrjen ilegale të inerteve dhe hedhjen e mbeturinave në lumenj.

Rreth 600 ha tokë bujqësore dhe një numër i konsiderueshëm i objekteve të banimit janë të rrezikuara nga vërshimet, veçanërisht në zonat e ulëta përgjatë Sitnicës dhe Llapit. Rreziku shtohet gjatë periudhës pranverore për shkak të kombinimit të reshjeve dhe shkrirjes së borës.

#### 4.12.6.4. ZJARRET

Komuna është e ekspozuar ndaj zjarreve pyjore në zonat kodrinore dhe malore, veçanërisht gjatë periudhave të thata verore. Rreziku ekziston edhe në zonat urbane dhe industriale për shkak të instalimeve elektrike të vjetruara, magazinimit të lëndëve të djegshme dhe objekteve industriale.

#### 4.12.6.5. RREZIQET TJERA

Rreziqe shtesë përfshijnë ndërtimet ilegale në zonat e rrjeteve energjetike, ekspozimin ndaj rrezatimit nga antenat transmetuese, vendosjen e pajisjeve elektrike në nivele të rrezikshme, ndërtimin e pompave të karburanteve në zona të banuara dhe grumbullimin e mbeturinave, të cilat paraqesin rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin.

## 4.13. ANALIZA SWOT

### 4.13.1. ZONAT ME PROBLEME MJEDISORE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Ky seksion paraqet përmbledhjen e analizës së gjendjes ekzistuese mjedisore në Komunën e Vushtrrisë dhe identifikon zonat me probleme mjedisore, zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, si dhe faktorët përkeqësues dhe mundësitë për përmirësim. Analiza bazohet në përshkrimet e mëparshme të kushteve mjedisore, infrastrukturës, biodiversitetit dhe përdorimit të tokës.

#### Zonat që vuajnë nga degradim i thellë mjedisor

Lumenjtë dhe përroskat në territorin e Komunës së Vushtrrisë paraqesin një nga zonat më të degraduara mjedisore. Lumi Sitnica, Llapi, Tërstena, Studimja dhe përroskat urbane dhe rurale janë të ndotura nga shkarkimet e ujërave të zeza komunale dhe industriale, mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura dhe hedhja e mbeturinave të ngurta në shtratet e lumenjve. Kjo gjendje ndikon negativisht në cilësinë e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor, biodiversitetin ujor dhe shëndetin publik.

Zonat urbane dhe përgjatë rrugëve magjistrale dhe rajonale përballen me ndotje të ajrit dhe zhurmë të shtuar për shkak të trafikut intensiv, automjeteve të vjetruara dhe standardeve jo të mjaftueshme të karburanteve dhe shkarkimeve. Rritja e numrit të automjeteve në të ardhmen, nëse nuk shoqërohet me masa për përmirësimin e transportit publik dhe standardeve mjedisore, pritet të rrisë presionin mbi cilësinë e ajrit dhe nivelin e zhurmës.

Aktivitetet industriale, guoret dhe nxjerrja e materialeve ndërtimore përbëjnë burime shtesë të degradimit mjedisor, duke shkaktuar ndotje të tokës, pluhur, zhurmë dhe degradim të peizazhit. Në zonat kodrinore dhe malore, degradimi i pyjeve, prerjet ilegale dhe përdorimi jo i qëndrueshëm i tokës kanë rritur rrezikun e erozionit dhe rrëshqitjeve të dheut.

#### Zonat që kanë nevojë për mbrojtje mjedisore

Territori i Komunës së Vushtrrisë përmban zona me vlera të rëndësishme natyrore dhe biodiversiteti, të cilat kërkojnë mbrojtje të veçantë gjatë planifikimit hapësinor dhe zhvillimit urban.

Komplekset pyjore të Sllakovcit–Vesekovcit dhe Qyqavicës përfaqësojnë zona me rëndësi të lartë ekologjike dhe peizazhore, me larmi floristikë dhe vegjetative, por me gjendje të degraduar për shkak të veprimit antropogjen. Këto zona përbëjnë habitat për shumë lloje të florës dhe faunës dhe luajnë rol të rëndësishëm në rregullimin e klimës lokale, ruajtjen e tokës dhe ciklin hidrogjik.

Zonat kodrinore dhe malore të Qyqavicës dhe Kopaonikut, si dhe sipërfaqet bujqësore me bonitet të lartë, duhet të ruhen nga ndërtimet e pakontrolluara dhe fragmentimi i habitateve. Zhvillimi i pakontrolluar urban dhe industrial në këto zona mund të shkaktojë prishjen e korridoreve ekologjike, fragmentimin e ekosistemeve dhe humbjen e biodiversitetit.

Objektet dhe zonat me vlera natyrore dhe peizazhore duhet të identifikohen dhe të trajtohen me masa mbrojtëse institucionale, duke u integruar në politikat e planifikimit hapësinor dhe në instrumentet lokale të mbrojtjes së natyrës.

### **Natyrat dhe shkalla e ndikimeve të mundshme mjedisore**

Problemet kryesore mjedisore të identifikuar në Komunën e Vushtrrisë përfshijnë menaxhimin e pamjaftueshëm të ujërave të zeza, ndotjen e ajrit, degradimin e tokës dhe biodiversitetit, menaxhimin e mbeturinave dhe presionet nga zhvillimi urban dhe infrastruktura.

Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimi jo adekuat i mbeturinave paraqesin rrezik të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin publik. Degradimi i lumenjve dhe eksploatimi i pakontrolluar i rërës dhe zhavorrit mund të ndikojnë në uljen e nivelit të ujërave nëntokësore dhe destabilizimin e shtretërve lumorë.

Ndërtimet pa kritere në tokat bujqësore me bonitet të lartë dhe në zonat kodrinore rrisin rrezikun e erozionit, rrëshqitjeve dhe përmytjeve, si dhe fragmentimin e ekosistemeve. Projektet infrastrukturore të realizuara pa vlerësim të ndikimit në mjedis kanë kontribuar në prishjen e korridoreve ekologjike dhe zhvendosjen e faunës.

Megjithëse degradimi mjedisor është i pranishëm, shumica e problemeve janë të trajtueshme nëse masat planifikuese dhe investimet realizohen në kohë dhe në mënyrë të koordinuar. Ekzistojnë politika dhe legjislacion mjedisor në nivel qendror dhe lokal, të cilat ofrojnë bazë për ndërhyrje parandaluese dhe rehabilituese.

### **Aspektet mjedisore dhe shëndetësore**

Deri më tani, mungojnë studime të detajuara që lidhin drejtpërdrejt cilësinë e mjedisit me shëndetin e popullsisë në Komunën e Vushtrrisë. Raportet në nivel qendror tregojnë se siguria e ujit të pijshëm, ndotja e ajrit dhe siguria rrugore janë ndër shqetësimet kryesore shëndetësore. Këto gjetje sugjerojnë nevojën për kalim nga qasja kurative në atë parandaluese, duke integruar masat mjedisore në politikat shëndetësore dhe planifikimin hapësinor.

## **4.14. ANALIZA SWOT MJEDISORE – KOMUNA E VUSHTRRISË**

Analiza SWOT paraqet faktorët kryesorë të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në gjendjen mjedisore të Komunës së Vushtrrisë dhe shërben si bazë për identifikimin e masave strategjike në Planin Zhvillimor Komunal.

### **Pikat e forta**

Komuna e Vushtrrisë posedon potencial të konsiderueshëm natyror dhe mjedisor, me komplekse të mëdha pyjore në zonat e Qyqavicës dhe Sllakovc–Vesekovc, të cilat përbëjnë resurse të rëndësishme ekologjike dhe peizazhore. Pozita gjeografike e favorshme dhe lidhjet e mira rrugore me qendrat kryesore urbane krijojnë kushte për zhvillim të integruar dhe menaxhim më të mirë të infrastrukturës mjedisore.

Ekziston një bazë ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë politikat kombëtare dhe lokale, si dhe dokumentet strategjike komunale që adresojnë çështjet e ujit, mbeturinave, biodiversitetit dhe planifikimit hapësinor. Prania e tokave bujqësore me bonitet të lartë dhe burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore përbën potencial të rëndësishëm për zhvillim të qëndrueshëm rural.

## Dobësitë

Menaxhimi i ujërave të ndotura dhe mbeturinave mbetet i pamjaftueshëm, me mungesë të impianteve të trajtimit dhe shkarkime direkte në lumenj dhe përroska. Ndotja e ajrit nga trafiku, industria dhe djegia e karburanteve fosile është e pranishme, veçanërisht në zonat urbane dhe përgjatë korridoreve kryesore rrugore.

Degradimi i pyjeve nga prerjet ilegale, mungesa e ripyllëzimit dhe përdorimi jo i qëndrueshëm i tokës kanë rritur rrezikun e erozionit dhe humbjes së biodiversitetit. Ndërtimet pa kriterë në tokat bujqësore dhe zonat kodrinore kanë shkaktuar fragmentim të habitateve dhe presion mbi ekosistemet natyrore.

Kapacitetet institucionale dhe financiare për monitorim dhe zbatim të politikave mjedisore janë të kufizuara, ndërsa ndërgjegjësimi publik për mbrojtjen e mjedisit mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

## Mundësitë

Zhvillimi i projekteve të menaxhimit të integruar të mbeturinave, ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe përmirësimi i sistemeve të furnizimit me ujë paraqesin mundësi për përmirësim të ndjeshëm të cilësisë mjedisore. Integrimi i masave të gjelbërimit urban, efikasitetit energjetik dhe energjive të ripërtëritshme në zhvillimin urban dhe rural ofron mundësi për uljen e ndotjes dhe rritjen e reziliencës klimatike.

Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe restaurimi i ekosistemeve të degraduara mund të përmirësojë biodiversitetin, stabilitetin e tokës dhe kapacitetet e sekuestrimit të karbonit. Zhvillimi i turizmit natyror dhe rekreativ në zonat e Qyqavicës dhe Kopaonikut krijon mundësi për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Fonde ndërkombëtare, programe të BE-së dhe partneritete publike-private mund të shfrytëzohen për investime mjedisore dhe projekte të infrastrukturës së gjelbër.

## Kërcënimet

Ndryshimet klimatike pritet të rrisin frekuencën e thatësirave, përmytjeve dhe fenomeneve ekstreme, duke ndikuar në burimet ujore, bujqësi dhe biodiversitet. Urbanizimi i shpejtë dhe ndërtimet pa planifikim adekuat mund të intensifikojnë degradimin e tokës, fragmentimin e habitateve dhe presionin mbi resurset natyrore.

Rritja e trafikut dhe industrializimi pa masa mjedisore mund të përkeqësojnë cilësinë e ajrit dhe zhurmën. Eksploatimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, përfshirë rërën, zhavorrin dhe drurin, përbën kërcënim për stabilitetin ekologjik dhe hidrologjik.

Mungesa e zbatimit efektiv të legjisllacionit mjedisor dhe monitorimit institucional mund të pengojë arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.


## 5. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJËS SË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

### 5.1. VIZIONI DHE SKENARET E ZHVILLIMIT

#### 5.1.1. VIZIONI I KOMUNËS SË VUSHTRRIË

Vushtrria – Qytet i lashtë me trashëgimi të pasur kulturore, vend me toka bujqësore, atraktiv dhe dinamik në zhvillimin e bujqësisë dhe agrobiznesit. Vend i turizmit malor – rekreativ dhe kulturor, në mjedis të pastër ekologjik. Vend me potencial të madh të popullsisë së re dhe të kualifikuar.

Lorem ipsum dolor sit amet, consectetur adipiscing elit, sed do eiusmod tempor incididunt ut labore et dolore magna aliqua. Quis ipsum suspendisse ultrices gravida. Risus commodo viverra maecenas accumsan lacus vel facilisis.



## 5.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHË-së SIPAS FUSHAVE TEMATIKE

### 5.2.1. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT SIPAS FUSHAVE TEMATIKE (NARRATIV PËR VSM)

#### 5.2.2. ZHVILLIMI EKONOMIK

Qëllimi kryesor në fushën e zhvillimit ekonomik është krijimi i një ekonomie të qëndrueshme, konkurruese dhe të orientuar drejt teknologjisë dhe inovacionit. Për këtë qëllim synohet hartimi i strategjive për funksionimin më efikas dhe profitabil të sektorit ekonomik, lehtësimi i klimës së të bërit biznes dhe tërheqja e investimeve private deri në vitin 2033, si dhe promovimi i sipërmarrjes inovative dhe start-upeve përmes subvencioneve dhe mentorimit. Po ashtu parashihet rritja e investimeve kapitale dhe kapaciteteve prodhuese, si dhe ulja e nivelit të papunësisë përmes trajnimeve dhe orientimit të punëkërkuësve në tregun e punës.

Një fokus i veçantë i kushtohet zhvillimit dhe fuqizimit të zonave ekonomike dhe industriale, përmes hartimit të planeve rregulluese, sigurimit të lidhjes infrastrukturore me rrjetin rrugor dhe infrastrukturën teknike, vendosjes së bizneseve në parqet industriale dhe inicimit të zonave të reja ekonomike dhe teknologjike.

Zhvillimi i aktiviteteve komerciale në korridoret zhvillimore dhe qendrat urbane synon rritjen e numrit të bizneseve me vlerë të shtuar, zhvillimin e mikro-qendrave komerciale, sigurimin e lidhjeve infrastrukturore dhe identifikimin e parcelave komunale për zhvillim komercial.

Turizmi identifikohet si sektor kyç për zhvillim ekonomik, duke synuar fuqizimin e turizmit kulturor, historik, natyror dhe rural, rritjen e kapaciteteve akomoduese, zhvillimin e infrastrukturës turistike dhe rrjetit informues, si dhe promovimin e traditave lokale dhe produkteve bujqësore.

Në sektorin e bujqësisë dhe agro-industrisë synohet rritja e konkurrueshmërisë, nxitja e zingjirit agro-ushqimor, investimet në infrastrukturë bujqësore, diversifikimi i fermave, rritja e fondit blegtoral dhe bletar, konsolidimi i tokave bujqësore dhe zhvillimi i shpezëtarisë.

#### 5.2.3. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

##### 5.2.3.1. RRJETI I UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

Qëllimi është sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe sistemit të plotë të kanalizimit për një mjedis të shëndetshëm. Objektivat përfshijnë furnizimin 24/7 me ujë cilësor për të gjithë popullsinë, lidhjen e mbi 90% të popullsisë në kanalizim dhe trajtimin e plotë të ujërave të ndotura, përmirësimin e cilësisë ekologjike të ujërave sipërfaqësore, menaxhimin e ujërave atmosferikë, ripërdorimin e ujërave të shiut dhe fuqizimin institucional për monitorim dhe kontroll të cilësisë së ujit.

##### 5.2.3.2. UJITJA DHE DRENAZHIMI

Synohet përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe drenazhit për zhvillimin e bujqësisë dhe mbrojtjen nga përmytjet, përmes zgjerimit të sipërfaqeve të ujitshme, aplikimit të teknologjive moderne të ujitjes, ndërtimit të rrjetit të kanalizimit atmosferik, rehabilitimit të rrjeteve kulluese dhe ripërdorimit të ujit të shiut në bujqësi.

### **5.2.3.3. ENERGJIA ELEKTRIKE**

Qëllimi është modernizimi dhe balancimi i sistemit të furnizimit me energji elektrike përmes rehabilitimit të nënstacioneve, ndërtimit të linjave të reja, krijimit të rrjeteve unazore kabllore në zonën urbane dhe përmirësimit të ndriçimit publik me sisteme efikase dhe inteligjente.

### **5.2.3.4. ENERGJIA TERMIKE**

Parashihet hulumtimi dhe zhvillimi i sistemit të ngrohjes qendrore dhe gazifikimit përmes studimeve të fizibilitetit dhe inicimit të sistemit të distribuimit të gazit natyror.

### **5.2.3.5. TELEKOMUNIKIMI**

Synohet zhvillimi i infrastrukturës moderne të telekomunikimit për transformim digjital, me mbulim broadband dhe 5G, si dhe zbatimin e koncepteve “Smart City”.

### **5.2.3.6. GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE**

Qëllimi është menaxhimi i qëndrueshëm dhe i integruar i mbeturinave përmes eliminimit të deponive ilegale, zgjerimit të infrastrukturës së grumbullimit për mbulim të plotë, ndërtimit të stacioneve transferuese dhe qendrave të sortimit dhe përpunimit, krijimit të bazës së të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, zhvillimit të sistemit të ndarjes në burim, riciklimit dhe kompostimit, si dhe menaxhimit të rrjedhave specifike të mbeturinave të rrezikshme, industriale, medicinale, shtazore dhe ndërtimore.

### **5.2.4. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI**

Qëllimi është zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së transportit përmes ndërtimit të segmenteve strategjike rrugore, përmirësimit të nivelit të shërbimit, devijimit të trafikut tranzit, modernizimit të linjës hekurudhore dhe zhvillimit të transportit publik. Parashihet mobilitet i qëndrueshëm, infrastrukturë për këmbësorë dhe çiklistë, sisteme inteligjente të transportit dhe optimizim i parkimeve.

### **5.2.5. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE**

Qëllimet përfshijnë përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies sociale, sigurimin e arsimit cilësor, digjitalizimin e administratës, zhvillimin e kulturës, rinisë dhe sportit, si dhe zhvillimin e hapësirave publike dhe infrastrukturës së gjelbër.

### **5.2.6. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI**

Synohet përmirësimi i cilësisë së ajrit, mbrojtja e resurseve ujore, parandalimi i degradimit të tokës, reagimi ndaj fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike, si dhe mbrojtja e biodiversitetit dhe zonave natyrore.

### **5.2.7. TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE**

Qëllimi është ruajtja, konservimi dhe rigjenerimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, promovimi i saj për turizëm dhe zhvillim ekonomik, si dhe mirëmbajtja sistematike e aseteve të trashëgimisë.

### **5.2.8. VENDBANIMET**

Synohet zhvillimi i harmonizuar urban dhe rural, balancimi i investimeve dhe përmirësimi i kushteve të jetesës dhe infrastrukturës.



#### **5.2.9. VENDBANIMET JOFORMALE**

Qëllimi është integrimi i vendbanimeve joformale në planifikimin hapësinor, përmirësimi i kushteve socio-ekonomike, legalizimi i pronësisë dhe integrimi infrastrukturor dhe mjedisor.

#### **5.2.10. BANIMI**

Synohet sigurimi i banimit të qëndrueshëm dhe të përballueshëm, rritja e efikasitetit energjetik dhe ndërtimi i njësive të banimit social.

#### **5.2.11. SHFRYTËZIMI I TOKËS**

Qëllimi është shfrytëzimi efikas dhe i qëndrueshëm i tokës, mbrojtja e tokës bujqësore, pyjore dhe ujore, zhvillimi i zonave ekonomike dhe turistike, zgjerimi i infrastrukturës rrugore dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

### 5.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR



#### 5.3.1. SKEMA KRAHASUESE E SKENARËVE TË PROPOZUAR





Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për Komunën e Vushtrrisë u zhvillua duke përdorur konceptet hapësinore vijuese për të arritur qëllimet dhe objektivat hapësinore.

Në konceptin kryesor të Zhvillimit Hapësinor janë marrë parasysh dhe është reflektuar gjendja aktuale dhe zhvillimet e planifikuara. Është caktuar logjika hapësinore dhe është bërë integrimi i kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit, qëllimeve dhe objektivave të drejtorive përkatëse të Komunës së Vushtrrisë, përmes tërësive të zgjidhjeve të planifikuara.

Në vijim në mënyrë të përgjithshme janë prezantuar nëpërmjet përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet për zhvillim për komunën.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor është baza kryesore e zhvillimit dhe shfrytëzimit të tokës për hartat tematike të PZHK-ja. Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara në skenare dhe të përvetësuara në konceptin kryesor janë **nyjet, korridoret, plotësimi dhe dendësimi, mbajtja nën kontroll, mbrojtja dhe zonat e rritjes**, të cilat janë analizuar edhe me implikime financiare përveç si përmbajtje dhe elemente hapësinore.

<p><b>NYJET</b></p> 	<p>Përcaktimi i disa nyjeve dhe trajtimi i tyre si pika hapësinore të përqendruara ku promovohet densifikimi i banimit, intensifikimi i funksioneve dhe aktiviteteve</p>	<p>Për <b>NYJET</b> si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky skenar bazohet në zhvillimin e disa nyjeve që i konsideron të rëndësishme. Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Vushtrrisë si qendër e rendit të parë.</p> <p>Nyjet e tjera të rëndësishme vendbanimet Maxhunaj, Smerkonicë, Pantinë, Novolan, Samadrexhë dhe Prelluzhë, zhvillohen si qendra të rendit të dytë apo qendra me potencial ekonomik, ndërsa nyjet tjera ekzistuese do trajtohen mjaftueshëm brenda kufijve aktual si qendra bazike.</p>
<p><b>KORRIDORET</b></p> 	<p>Trajtimi i disa lidhjeve/korridoreve ndërmjet nyjeve, përgjatë të cilave natyrshëm mund të nxitet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit</p>	<p><b>KORRIDORET</b>, në kuadër të këtij skenari trajtojnë vijat më të rëndësishme të zhvillimit, transportit, telekomunikacionit dhe korridoret ekonomike-tregtare. Përfshijnë linjat e transportit që bëjnë ndërlidhjen e vendbanimeve në mes veti por edhe janë nyje kryesore për gjithë regjionin. Korridor i rëndësishëm i këtij skenari është korridori hekurudhor që lidhë Vushtrrinë me Fushë Kosovën, Lipjanin, Ferizajn me Maqedoninë Veriore, pjesën veriore Mitrovicë, Leshak dhe pjesën perëndimore Fushë Kosovë, Glllogoc, Pejë. Sa i përket hapësirave zhvillimore komerciale (korridoreve) të zhvillimit ekonomik, ky skenar propozon fuqizimin e korridorit që kalon nga Prishtina në drejtim të Mitrovicës, Korridoret zhvillimore ekzistuese do të monitorohen dhe rehabilitohen, kurse zhvillimi përreth korridoreve të reja duhet të planifikohet me kujdes.</p>

<p><b>PLOTËSIM DHE DENDËSIM</b></p> 	<p>Paraqet mundësi dhe potencial të mbushjes dhe densifikimit të hapësirave me zhvillime të caktuara, për të arritur zhvillim hapësinor kompakt dhe për të rritur pragun e popullsisë</p>	<p>Në lidhje me <b>PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN</b>, skenari ofron plotësim dhe dendësim në zonën urbane, duke u zgjeruar në drejtim të lindjes të qytetit. Sipas nevojave plotësim dhe dendësim planifikohet edhe në vendbanime tjera, mirëpo gjithmonë të monitoruara dhe duke ruajtur zonat bujqësore.</p>
<p><b>MBAJTJA NËN KONTROLL</b></p> 	<p>Koncepti i Mbjajtjes nën Kontroll i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ulët, përmes përdorimit të kufirit për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore</p>	<p>Në lidhje me <b>MBAJTJEN NËN KONTROLL</b>, synohet mbajtja nën kontroll e të gjithë kufinjve të ri ndërtimor, qoftë të zonës urbane, qoftë të vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim. Po ashtu synohet të mbahet nën kontrollë vendbanimet që shtrihen në zona me komosacion dhe sistem të ujitjes për të mbrojtur tokat bujqësore.</p>
<p><b>MBROJTJA</b></p> 	<p>Koncepti i mbrojtjes i referohet nevojës për mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë</p>	<p>Në lidhje me <b>MBROJTJEN</b>, mbrohet toka bujqësore, dhe gjithashtu synohet mbrojtja e pasurive të tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për t'u shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate. Po ashtu skenari promovon mbrojtjen e zonave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore si:  Kalanë e Vushtrrisë, Urën e Gurit, Hamamin e Vjetër e shumë elemente të tjera.</p>
<p><b>ZONAT E RITJES</b></p> 	<p>Koncepti me Zona të Rritjes paraqet zhvillim të zonave ekzistuese me intensitet më të lartë dhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi i tokës</p>	<p>Në lidhje me <b>ZONAT E RITJES</b>, ofrohet ri-zhvillimi i zonave ekzistuese në intensitet më të lartë.  <b>Zonat e rritjes</b> përcaktohen duke u bazuar në resurse dhe potenciale për zhvillim, me mundësi drejt tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës.</p>

## 5.3.2. ELEMENTET KRYESORE MJEDISORE TË KONCEPTIT/SKENARIT HAPËSINOR

### 5.3.2.1. ZHVILLIMI HAPËSINOR I PËRQENDRUAR (URBAN COMPACT DEVELOPMENT)

Koncepti parasheh përqendrimin e zhvillimit urban dhe ekonomik përgjatë korridoreve kryesore të transportit dhe në zonën urbane qendrore të Vushtrrisë.

#### Aspekt mjedisor:

Redukton shtrirjen urbane të pakontrolluar.

Mbron tokat bujqësore dhe zonat natyrore nga fragmentimi.

### 5.3.2.2. ZONAT E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE INDUSTRIAL

Janë identifikuar zona për zhvillim industrial dhe ekonomik përgjatë korridoreve kryesore infrastrukturore.

#### Aspekt mjedisor:

Kërkon masa për menaxhimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës.

Nevojitet planifikim i zonave tampon (bufer zones) mes industrisë dhe vendbanimeve.

### 5.3.2.3. KORRIDORET E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURA STRATEGJIKE

Magjistralet, rrugët rajonale dhe linjat hekurudhore përbëjnë boshtet kryesore të zhvillimit.

#### Aspekt mjedisor:

Mund të rrisë ndotjen nga trafiku dhe fragmentimin e habitateve.

Kërkon masa për reduktimin e zhurmës dhe emetimeve (transport publik, mobilitet i qëndrueshëm).

### 5.3.2.4. ZONAT BUJQËSORE DHE RUAJTJA E TOKËS PJELLORE

Harta identifikon zona bujqësore me rëndësi dhe tokë të klasave të larta.

#### Aspekt mjedisor:

Koncepti mbështet ruajtjen e tokave pjellore nga urbanizimi.

Kontribuon në sigurinë ushqimore dhe ruajtjen e peizazhit rural.

### 5.3.2.5. ZONAT PYJORE DHE NATYRORE

Paraqiten zona pyjore, zona natyrore dhe zona me vlera ekologjike.

#### Aspekt mjedisor:

Koncepti i njeh si zona mbrojtëse dhe kufizon zhvillimin intensiv.

Kontribuon në ruajtjen e biodiversitetit dhe shërbimeve ekosistemore.

### 5.3.2.6. ZONAT REKREATIVE, TURISTIKE DHE KULTURORE

Janë identifikuar zona për turizëm, rekreacion dhe trashëgimi kulturore.

#### Aspekt mjedisor:

Potencial për zhvillim të turizmit të qëndrueshëm.

Kërkon menaxhim për të shmangur presionin mbi ekosistemet dhe trashëgiminë natyrore.

### 5.3.2.7. ZONAT E RREZIKUT MJEDISOR DHE KUFIZIMET ZHVILLIMORE

Harta paraqet zona me kufizime zhvillimore, përfshirë zonat e përmytjeve, tokat e paqëndrueshme dhe zonat e mbrojtura.

**Aspekt mjedisor:**

Koncepti synon shmangien e ndërtimit në zona me rrezik natyror.

Mbështet adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut.

### 5.3.2.8. INFRASTRUKTURAT ENERGJETIKE DHE TEKNIKE

Janë identifikuar linjat elektrike, burimet e energjisë dhe zonat infrastrukturore.

**Aspekt mjedisor:**

Mundësi për integrim të burimeve të ripërtëritshme.

Kërkon masa për reduktimin e ndikimit vizual dhe ekologjik.

### 5.3.2.9. STRUKTURAT E NDËRTUARA DHE DENSIFIKIMI URBAN

Koncepti promovon densifikim në zona urbane ekzistuese dhe zhvillim të kontrolluar në periferi.


**Aspekt mjedisor:**

Ul presionin mbi zonat natyrore dhe bujqësore.

Rrit efikasitetin e shërbimeve infrastrukturore dhe energjetike.

### 5.3.2.10. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR I KOMUNËS SË VUSHTRISË:

Mbështet parimet e zhvillimit të qëndrueshëm përmes përqendrimit të zhvillimit urban, ruajtjes së zonave bujqësore dhe natyrore, identifikimit të zonave me kufizime mjedisore dhe promovimit të korridoreve strategjike të infrastrukturës. Megjithatë, zbatimi i këtij koncepti kërkon masa të qarta mjedisore për menaxhimin e ndotjes, fragmentimit të habitateve, rreziqeve natyrore dhe ndikimeve të zhvillimit industrial dhe transportit.



Harta. 11 Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të komunës së Vushtrisë

#### 5.4. DISA NGA ASPEKTE KRYESORE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE

Të dhënat më poshtë i referohen gjëndjes mjedisore të tanishme në komunën e Vushtrrisë. Qëllimi kryesor i diskutimit të të dhënave bazë është të identifikojë gjëndjen mjedisore në ballafaqim me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë. Impaktet potenciale të zhvillimit të PZHK-së mund të vlerësohen nga ndryshueshmëria e kushteve mjedisore me ose pa implementimin e Planit nëpërmjet indikatorëve të gjendur/të supozuar sasiorë ose cilësorë. Esencialisht, gjëndja mjedisore e komunës e Vushtrrisë karakterizohet nga përshkrimi i receptorve mjedisore, siç kërkohet nga Direktiva e VSM, të përshkruara më poshtë:

- Popullsia dhe Shëndeti publik;
- Fitodiversiteti dhe Zoodiversiteti;
- Zonat e mbrojtura të natyrorës;
- Cilësia e ajrit;
- Bezdisjet- zhurma kundërmimi pamjet e pa këndshme;
- Faktorët klimatikë, ndryshimet klimatike;
- Uji në përgjithësi;
- Toka bujqësore dhe peisazhi;
- Asete materiale/Infrastruktura fizike (transporti dhe administrimi mbetjeve);
- Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike);
- Trashëgimia natyrore (Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore).

##### 5.4.1. POPULLSIA DHE SHËNDETI PUBLIK

Ndikimet në shëndetin e publik për VSM, janë ato të cilat lindin si pasojë e bashkëveprimit me receptorët mjedisorë (komponente mjedisore të tilla si ajëri, uji apo tokë nëpërmjet të cilëve ndotësit bëhen potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit më njerëzit. Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para së gjithash, ruajtja në nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dëndësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapsirave publike rekreative dhe sidomos të gjelbërta sjell pa dyshim uljen e cilësisë së jetës, përkeqesimin e parametrave mjedisorë të pranuar si standarde, shpenzime të larta të shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me të larta për mbrojtjen e shëndetit.

Ne komunën e Vushtrrisë, shërbimi shëndetësor parësor ofrohet nëpërmjet QKMF dhe QMF, kurse sekondar përmes Spitalit Rajonal të Mitrovicës.

#### 5.4.1.1. NDIKIMET MJEDISORE TË LIDHURA ME POPULLSINË DHE SHËNDETIN

Më poshtë, janë identifikuar disa ndikime që janë të lidhura për shëndetin në tërësi:

- Ndertimi/rehabilitimi i kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave të zeza si dhe manaxhimi i mbetjeve.
- Rehabilitimi i zonave me ndotje të lart dhe atyre që janë potencial për ndotje të komponenteve mjedisore;
- Ruajtja e burimeve të ujit të pishëm nga ndotja;
- Konsiderimi i kërkesës së rritur të infrastrukturës intensive në vendbanimet me densitet të lartë;
- Promovimi i mobilitetit, ecjesë dhe çiklizmit;
- Rikonsiderimi i trafikut publik për uljen e emetimit të gazeve dhe zhurmave;
- Cilësia e ndërtesave, densiteti dhe zonimi duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga shërbime dhe facilitetet të tjera komunale në disa vendbanime të komunës;
- Raportet ndërtimore me sipërfaqet e gjelbërta duhet të parashikojnë densitetin e popullsisë;
- Sipërfaqet aktuale të gjelbërta dhe parqet duhet të zhvillohen dhe mirëmbahen;
- Rritja e koordinimit me autoritetet paralele planifikuese për të vlerësuar impaktet mjedisore në shëndetin e njeriut;

#### Veçori natyrore kryesore të komunës dhe zonat që ndikohen

Te pjesa e gjendjës ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçorit natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore.

Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzjerje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensitivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta.

Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustron në disa nga shifrat që mund të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani. Shumfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të toke bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një tërsie pejsazhesh e gjelbrimi.

#### Zonimi i territorit të komunës

Duke u bazuar në tipologjinë e vendbanimeve, popullsitë, infrastrukturën shoqëruese arkitekturat, gjeomorfologjitet dhe sidomos çështjet mjedisore që mund të paraqesin komunën e Vushtrrisë me PZHK janë trajtuar si më poshtë:

#### Zonat e ndërtimit në vendbanime:

#### Zonat e pazhvilluara me ndërtim

PZHK-ja i ka identifikuar dhe trajtuar duke i destinuar si tokë bujqësore, tokë pyjore zona të mbrojtura natyrore dhe zona tjera të mbrojtura, zona për infrastruktur hidrografike dhe infrastruktur tjetër.

### **Zonat turistike**

PZHK ka identifikuar zonat turistike për të gjithë llojet e turizmit të mundshëm në komunën e Vushtrrisë dhe janë të prezantuar në hartën e turizmit.

### **Zona të mbrojtura**

PZHK-ja ka evidentuar gjithashtu zonën ku përfshihen zonat karakteristike me vlera të trashëgimis kulturore - historike, peisazhike, mjedisore e turistike të Komunës. Në këto zona nuk mund të jepen leje ndërtimi për objekte e struktura, të cilat çënojnë identitetin e zonës. Objektet ekzistuese të zonës mund të restaurohen vetëm në kushte të cilat i japin institucionet kompetente, duke mos çënuar identitetin e tyre.

### **Zona Industriale dhe zonat për zhvillime industrial**

Zona industrial planifikohet të jetë lokale, dhe do zhvillohen kryesisht ku tashmë është krijuar një bërthamë e një zone industriale në qytet ose aty ku vërtet ekzistojnë kushte të favorshme të zhvillimit të tyre dhe që nuk bie në konflikt me interesa tjera socio-ekonomike dhe mjedisore dhe zhvillimet industriale që janë identifikuar dhe trajtuar me PZHK dhe duhet propozuar masat mjedisore. Në hartë nuk është e paraqitur kufiri i zonës industriale.

### **Pyllëzimi dhe zhvillimi i pyjeve**

Pyllëzimi dhe zhvillimi i pyjeve në komunën e Vushtrrisë paraqet një komponentë të rëndësishme mjedisore, si në aspektin ekologjik ashtu edhe në aspektin socio-ekonomik. Pyjet luajnë rol kyç në mbrojtjen e tokës nga erozioni, rregullimin e regjimit hidrologjik, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Zonat pyjore në komunën e Vushtrrisë përfshijnë pyje me gjethë të gjera dhe pyje të përziera, të cilat shtrihen kryesisht në zonat kodrinoro-malore. Megjithatë, presioni nga shfrytëzimi ilegal i drurit, zgjerimi i vendbanimeve dhe infrastruktura ka ndikuar në degradimin e sipërfaqeve pyjore dhe fragmentimin e habitateve.

PZHK-ja parasheh masa për mbrojtjen dhe rehabilitimin e pyjeve, përfshirë pyllëzimin e zonave të degraduara dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve pyjore, në përputhje me politikat dhe strategjitë kombëtare për pylltari dhe biodiversitet.

### **Flora dhe fauna**

Komuna e Vushtrrisë karakterizohet me diversitet të moderuar floristik dhe faunistik, të lidhur ngushtë me tipologjinë e relievit, klimën dhe përdorimin e tokës. Habitatet natyrore përfshijnë ekosisteme pyjore, livadhe, toka bujqësore dhe ekosisteme ujore përgjatë lumenjve dhe burimeve ujore.

Ndikimet kryesore në florë dhe faunë lidhen me urbanizimin, fragmentimin e habitateve, ndotjen e ujërave dhe tokës, si dhe shfrytëzimin e pakontrolluar të burimeve natyrore. PZHK-ja synon të integrojë masa për ruajtjen e biodiversitetit, krijimin e korridoreve ekologjike dhe mbrojtjen e zonave me vlera të veçanta natyrore.

### **Burimet ujore**

Burimet ujore në komunën e Vushtrrisë përfshijnë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat janë të rëndësishme për furnizimin me ujë të pijshëm, bujqësi dhe ekosistemet natyrore. Regjimi hidrologjik ndikohet nga faktorët klimatikë, relievi dhe përdorimi i tokës.

Problemet kryesore lidhen me ndotjen e ujërave nga ujërat e zeza të patrajuara, aktivitetet bujqësore dhe industriale, si dhe me mungesën e infrastrukturës adekuate për trajtimin e ujërave të ndotura. PZHK-ja parasheh zhvillimin e sistemeve të kanalizimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, si dhe masa për mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja dhe shfrytëzimi i pakontrolluar.

### **Toka dhe peisazhi**

Toka në komunën e Vushtrrisë përfshin toka bujqësore, pyjore dhe toka ndërtimore. Presioni nga urbanizimi dhe ndërtimet e pakontrolluara ka çuar në humbjen e tokës bujqësore dhe degradimin e peisazhit natyror.

Peisazhi karakterizohet nga një kombinim i zonave urbane, fushore dhe kodrinoro-malore, me vlera estetike dhe ekologjike. PZHK-ja synon të ruajë identitetin peisazhik të komunës dhe të promovojë zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, duke balancuar nevojat e zhvillimit me mbrojtjen e mjedisit.

### **Luhatjet klimatike (ciklet klimatike flutacionet) dhe faktorët klimatikë**

Në Komunën e Vushtrrisë sikur se në gjithë hemisferen tonë kemi luhatje ndodhemi në një cikël klimatik i cili është e ekspozuar, rritjes së temperaturave, ndryshimet në regjimin e reshjeve dhe rritjen e frekuencës së ngjarjeve ekstreme, si përmbytjet dhe thatësitrat.

PZHK-ja duhet të integrojë masa të adaptimit dhe mitigimit (zvogëlimi ose parandalimi i ndikimeve negative në mjedis) ndaj ndryshimeve klimatike, përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, promovimin e energjive të ripërtëritshme, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe planifikimin e qëndrueshëm urban.

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Vushtrrisë paraqet një nga sfidat kryesore mjedisore. Sistemi aktual i grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave nuk mbulon në mënyrë të plotë të gjitha vendbanimet, veçanërisht zonat rurale. Praktikët e deponimit ilegal dhe mungesa e ndarjes së mbeturinave në burim kontribuojnë në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit.

PZHK-ja parasheh përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, përfshirë zgjerimin e mbulimit të shërbimeve të grumbullimit, krijimin e infrastrukturës për ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave, rehabilitimin e deponive ilegale dhe ngritjen e vetëdijes publike për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

## 6. PARIME, QËLLIME DHE KRITERE MJEDISORE

### 6.1. QËLLIMET E VSM-SË

Duke u bazuar në qëllimin kryesor të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, që është integrimi i konsideratave mjedisore në Planin Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë, janë përcaktuar qëllimet mjedisore strategjike. Këto qëllime janë në përputhje me politikat dhe strategjitë mjedisore kombëtare, Planin Hapësinor të Kosovës, dokumentet sektoriale për ujëra, biodiversitet, klimë dhe mbrojtje të natyrës, si dhe me prioritetet e zhvillimit të Komunës së Vushtrrisë.

Qëllimet mjedisore janë të strukturuar në qëllime strategjike (globale) dhe qëllime lokale në nivel komunal. Për secilin qëllim janë identifikuar ndikimet e mundshme negative në rast të moszbatimit të masave zbutëse dhe parandaluese.

#### 6.1.1. QËLLIMI MJEDISOR 1 (QM1) – AJRI

Qëllimi është përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i emetimeve të gazrave serrë përmes promovimit të transportit të qëndrueshëm, mobilitetit aktiv (çiklizëm dhe ecje), përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe zbatimit të standardeve evropiane për emetimet. Në Komunën e Vushtrrisë, ky qëllim lidhet me uljen e ndotjes nga trafiku, industria dhe ngrohja rezidenciale, si dhe me rritjen e sipërfaqeve të gjelbra urbane.

#### 6.1.2. QËLLIMI MJEDISOR 2 (QM2) – UJI

Qëllimi është përmirësimi dhe ruajtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, parandalimi i ndotjes nga ujërat e zeza dhe aktivitetet industriale, rritja e kapacitetit për deponimin dhe menaxhimin e ujit, si dhe promovimi i përdorimit racional të ujit. Në Vushtrri, ky qëllim lidhet me zhvillimin e sistemeve të kanalizimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, mbrojtjen e burimeve ujore dhe reduktimin e humbjeve në rrjetin e ujësjellësit.

#### 6.1.3. QËLLIMI MJEDISOR 3 (QM3) – TOKA

Qëllimi është mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tokës, parandalimi i degradimit dhe erozionit, ruajtja e tokave bujqësore me bonitet të lartë dhe garantimi i kapacitetit prodhues të tokës. Në Komunën e Vushtrrisë, ky qëllim lidhet me kontrollin e urbanizimit në tokat bujqësore, menaxhimin e zonave kodrinore dhe parandalimin e rrëshqitjeve dhe erozionit.

#### 6.1.4. QËLLIMI MJEDISOR 4 (QM4) – BIODIVERSITETI

Qëllimi është mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve dhe habitateve natyrore, veçanërisht specieve të rralla dhe të kërcënuara, dhe ruajtja e funksionalitetit të ekosistemeve. Për Vushtrrinë, ky qëllim lidhet me mbrojtjen e zonave natyrore, korridoreve ekologjike dhe integrimin e biodiversitetit në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin urban.

#### 6.1.5. QËLLIMI MJEDISOR 5 (QM5) – PYJET

Qëllimi është menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve për të garantuar aftësinë vetëripërtëritëse të ekosistemit pyjor dhe për të kontribuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Në Vushtrri, ky qëllim përfshin pyllëzimin, mbrojtjen nga shpyllëzimi dhe zjarret, si dhe integrimin e pyjeve në strategjitë lokale të klimës dhe zhvillimit rural.

#### 6.1.6. QËLLIMI MJEDISOR 6 (QM6) – PEIZAZHI DHE EKOSISTEMET

Qëllimi është ruajtja dhe rivitalizimi i peizazheve natyrore dhe urbane, mbrojtja e karakteristikave dalluese të peizazhit dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore. Në Komunën e Vushtrrisë, ky qëllim lidhet me kontrollin e zhvillimit urban, ruajtjen e panoramave natyrore dhe integrimin e trashëgimisë kulturore në planifikimin hapësinor.

### **6.1.7. QËLLIMI MJEDISOR 7 (QM7) – NDRRIMET KLIMATIKE**

Qëllimi është reduktimi i kontributit të zhvillimit urban dhe infrastrukturës në ndrrimet klimatike, promovimi i energjisë së pastër, eficiencës energjetike dhe mobilitetit të qëndrueshëm. Në Vushtrri, ky qëllim lidhet me ndërtimet e qëndrueshme, transportin publik, gjelbërimin urban dhe masat për adaptim ndaj përmbytjeve dhe valëve të nxehtësisë.

### **6.1.8. QËLLIMI MJEDISOR 8 (QM8) – TRASHËGIMIA KULTURORE**

Qëllimi është ruajtja, konservimi dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale. Në Vushtrri, ky qëllim përfshin mbrojtjen e monumenteve, zonave historike dhe integrimin e tyre në zhvillimin urban dhe turistik.

### **6.1.9. QËLLIMI MJEDISOR 9 (QM9) – CILËSIA E JETËS**

Qëllimi është përmirësimi i shëndetit publik dhe mirëqenies së popullsisë, garantimi i zhvillimit socio-ekonomik në harmoni me mjedisin dhe ulja e ekspozimit ndaj rreziqeve natyrore. Në Komunën e Vushtrrisë, ky qëllim lidhet me rritjen e sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ujit, menaxhimin e mbeturinave dhe reduktimin e rreziqeve nga përmbytjet dhe fatkeqësitë natyrore.

### **6.1.10. PARIMET E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM**

Plani Zhvillimor Komunal i Vushtrrisë duhet të zbatojë parime të zhvillimit policentrik dhe të qëndrueshëm, ku shërbimet publike dhe infrastruktura të jenë të shpërndara në mënyrë të balancuar në territorin e komunës, duke reduktuar nevojën për udhëtime të gjata dhe duke ulur presionin mjedisor në qendrën urbane.

## **6.2. PARIME, OBJKTIVA E KRITERE MJEDISORE QE KUFIZOJNE ZHVILLIMIN KOMUNAL**

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

### **6.2.1. PARIMET E PËRGJITHSHME PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR**

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen në dhjetë pika si më poshtë:

1. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
3. Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;
4. Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen dhe komunikimin e habitateve mes vete;
5. Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjedisve natyrore;
6. Përfshirja e parimeve si “ndotësi paguan” ose “përdoruesi paguan”;
7. Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
8. Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme, bazuar në ndikim minimal, ndërtim pa ndotje dhe përgatitje të duhur të sheshit;
9. Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion;
10. Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të PZHK-së, parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme:

- Densifikim përpara shtrirjes – përdorim më efektiv i tokës brenda vendbanimeve dhe ngadalësim i zgjerimit të pakontrolluar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve – përmirësim i aksesit brenda komunës dhe me komunat fqinje;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Rizhvillimi i pyjeve ekzistuese dhe pyllëzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturo-historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit aty ku kushtet janë të favorshme.

### 6.2.2. OBJEKTIVA STRATEGJIKE

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat ndahen në objektiva primare/globale dhe objektiva lokale të nivelit komunal.

- Zhvillimi i mëtejshëm i vlerave demokratike, ku të gjithë aktorët e përfshirë e ushtrojnë të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre. Një nga qëllimet kryesore është pjesëmarrja cilësore gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti;
- Zhvillim i qëndrueshëm, i shpejtë dhe intensiv me ndryshime në strukturën socio-ekonomike dhe zhvillim të balancuar brenda territorit të komunës së Vushtrrisë;
- Krijimi i kushteve për rritje të qëndrueshme të punësimit, eliminim të varfërisë, përmirësim të shëndetit publik dhe forcim të rolit të sektorit privat në zhvillimin socio-ekonomik;
- Rritje e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (siguri sociale, fizike, mjedisore dhe arsimore);
- Zhvillimi i një partneriteti të gjerë për zhvillim.

Objektivat e mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë, përmes rritjes së sigurisë, shtimit të hapësirave të gjelbra, përmirësimin të cilësisë së ajrit dhe krijimit të kushteve për mënyrë aktive të jetesës.

Ndër të tjera, PZHK-ja duhet të zbatojë modele të pranuar zhvillimi, si p.sh. Komuna e Vushtrrisë si komunë policentrike, ku qytetari i merr shërbimet pranë vendbanimit të tij dhe nuk ka nevojë të udhëtojë vetëm drejt qendrës administrative.

PZHK-ja parashikon zhvillimin e Komunës së Vushtrrisë si një e tërë – nga vendbanimet, lagjet, deri te zonat më të vogla të banimit. Në këtë fazë jepen kufijtë, kriteret, intensitetet, densitetet dhe

standardet për të gjithë territorin komunal, ndërsa më pas detajimi bëhet përmes Planeve Rregulluese të Hollësishe.

Plani synon të përfshijë konceptin e menaxhimit të pronës në mënyrë të drejtë dhe pa dallime ndërmjet pronarëve gjatë përcaktimit të destinimeve të tokës (ndërtim, gjelbërim etj.).

Sfidë mbetet fakti që disa zona zhvillimore strategjike (infrastrukturë e re, zona industriale etj.) janë të përmendura në mënyrë të përgjithshme dhe kërkojnë analiza më të detajuara për ndikimin në korridoret ekologjike, qarkullimin natyror të faunës dhe ruajtjen e habitateve. Një sfidë tjetër është zbatimi praktik i objektivave për pyllëzim, ripyllëzim, krijim të shiritave të gjelbër, zona tampon dhe hapësira rekreative.

Plani gjithashtu synon integrimin dhe përmirësimin e situatës aktuale, përfshirë zgjerimin e vendbanimeve në drejtim të zonave me tokë më pak pjellore dhe me përdorim të përzier.

Një aspekt tjetër është rehabilitimi i pikave të nxehta mjedisore, të cilat kërkojnë identifikim dhe trajtim të detajuar.

### 6.2.3. OBJEKTIVAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

1. Pakësimi i sasisë së mbetjeve dhe menaxhimi i integruar i tyre;
2. Krijimi i një komune të qëndrueshme dhe të shëndetshme;
3. Identifikimi dhe krijimi i habitateve të reja dhe korridoreve të gjelbra;
4. Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i zhurmës;
5. Kursimi i energjisë dhe reduktimi i emetimeve të gazeve serrë;
6. Ruajtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore sipas legjislacionit të Kosovës dhe direktivave të BE-së;
7. Reduktimi i trafikut përmes promovimit të transportit publik, këmbësor dhe me biçikleta;
8. Mbrojtja dhe shtimi i vlerave kulturore;
9. Konservimi dhe shtimi i elementeve peizazhistike;
10. Mbrojtja e mjedisit natyror në zonat pyjore dhe kodrinore të komunës së Vushtrrisë;
11. Ripërdorimi i tokave të ndotura në vend të shfrytëzimit të tokave të reja.

### 6.2.4. VEPRIME OPERACIONALE PËR HAPËSIRAT E GJELBRA NË VUSHTRRI

1. Krijimi i projekteve për zonat e mbrojtura brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë;
2. Krijimi i parqeve të reja në dhe përreth vendbanimeve;
3. Krijimi dhe përmirësimi i korridoreve ekologjike, veçanërisht përgjatë lumenjve si Lumi Sitnica;
4. Krijimi i lulishteve dhe kopshteve publike në Vushtrri;
5. Kthimi i zonave të degraduara në sipërfaqe të gjelbra;

6. Gjelbërimi i oborreve private;
7. Mbjellja e pemëve dhe shkurreve përgjatë rrugëve dhe trotuareve;
8. Ngritja e barrierave të gjelbra përgjatë rrugëve me trafik të dendur.

#### 6.2.5. VEPRIME PËR PËRMIRËSIMIN E TRANSPORTIT

1. Ndërtimi i një rrjeti rrugor që lidh Vushtrrinë me rajonin dhe fshatrat mes vete;
2. Përmirësimi i rrugëve ekzistuese;
3. Krijimi i rrjeteve për biçiklistë dhe këmbësorë;
4. Përmirësimi i transportit publik;
5. Projektim i rrugëve me trotuare dhe korsi biçikletash sipas standardeve.

#### 6.2.6. KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNË ZHVILLIMIN KOMUNAL

Kriteret ndahen në:

- Kriteria mjedisore-shëndetësore;
- Kriteria të trashëgimisë kulturore;
- Kriteria peizazhike;
- Kriteria inxhinierike dhe infrastrukturore.

#### 6.2.7. ZONAT ME VLERA TË VEÇANTA MJEDISORE NË TERRITORIN E VUSHTRRISË PËRFSHIJNË:

- Zonat përgjatë Lumi Sitnica;
- Hapësirat pyjore dhe kodrinore në territorin komunal;
- Zonat bujqësore me vlerë të lartë prodhuese;
- Burimet ujore dhe basenet nëntokësore.

Në këto zona nuk duhet të lejohen ndërtime të pakontrolluara.

#### 6.2.8. KRITERE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Komuna e Vushtrrisë ka objekte me vlera të rëndësishme kulturore dhe historike si Kalaja e Vushtrrisë dhe Ura e Gurit në Vushtrri, të cilat duhet të ruhen dhe të integrohen në zhvillim pa cenuar karakterin e tyre.

## NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

## 7. TESTIMI I QËLLIMEVE TË PLANIT KUNDREJT OBJEKTIVAT TË VSM-së

VSM-ja duhet të jetë reale dhe funksionale në mbështetje të procesit të planifikimit në Komunën e Vushtrrisë. Për këtë arsye, fokusi i saj duhet të përqendrohet në identifikimin e çështjeve konkrete mjedisore që lidhen drejtpërdrejt me territorin komunal si në aspektin e problemeve ekzistuese, ashtu edhe të mundësive zhvillimore.

Problemet përfaqësojnë çështje kritike që kërkojnë ndërhyrje përmes Planit Zhvillimor Komunal, si p.sh. ndotja e ujërave sipërfaqësore, menaxhimi i mbetjeve, presioni mbi tokën bujqësore, zgjerimi i pakontrolluar i vendbanimeve apo degradimi i hapësirave të gjelbra. Këto janë fusha ku plani duhet të japë zgjidhje konkrete dhe të matshme.

Mundësitë, nga ana tjetër, lidhen me potencialet mjedisore të Vushtrrisë që mund të shfrytëzohen për zhvillim të qëndrueshëm si korridoret natyrore përgjatë Lumi Sitnica, tokat bujqësore me kapacitet prodhues, hapësirat për gjelbërim urban, si dhe trashëgimia kulturore me vlerë si Kalaja e Vushtrrisë. Këto elemente mund të integrohen në plan për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të rritur qëndrueshmërinë mjedisore.

Ky proces mundëson përcaktimin e objektivave specifike të VSM-së për Komunën e Vushtrrisë, të cilat shërbejnë si pikë reference gjatë hartimit të planit, por edhe gjatë zbatimit dhe monitorimit të tij. Objektivat e VSM-së janë identifikuar duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, politikat kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, si dhe prioritetet zhvillimore të vetë komunës.

Objektivi i përgjithshëm i Vlerësimit Strategjik Mjedisor në këtë kontekst është integrimi i çështjeve mjedisore në procesin e vendimmarrjes për Planin Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë. Kjo nënkupton që çdo politikë, program apo projekt i paraparë me plan të analizohet paraprakisht nga aspekti i ndikimit në mjedis, në mënyrë që informacioni mjedisor të përdoret si bazë për vendime më të sigurta, më të balancuara dhe më të qëndrueshme.

Pra, ky studim parasheh:

- Identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme mjedisore të zbatimit të PZHK-së në territorin e Vushtrrisë;
- Krahasimin e qëllimeve të planit me objektivat mjedisore të VSM-së;
- Propozimin e masave parandaluese dhe zbutëse për ndikimet negative;
- Forcimin e komponentit mjedisor në të gjitha fazat e zhvillimit komunal;
- Krijimin e një baze për monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes mjedisore gjatë zbatimit të planit.

Në këtë mënyrë sigurohet që zhvillimi i Komunës së Vushtrrisë të mos bëhet në dëm të mjedisit, por në harmoni me burimet natyrore dhe me interesin afatgjatë të komunitetit.

Tabela 1 Matrica e përputhshmërisë për të vlerësuar qëllimet e PZHK-së kundrejt Qëllimeve të VSM-së (vazhdon në Tabelën)

Qëllimet e VSM- së	QËLLIMET E ZHVILLIMIT EKONOMIK							
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5	Qëllimi 6	Qëllim 7	Qëllim 8
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	++	0	+	0	+	0
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	+/-	0	++	+	0	0	+	+/-
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	++	0	+	0	+	0	+	0
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	+/-	0	+	0	+	0	0	+/-
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	+	+	+	0	0	0	0	0
Q6: Ekosistemet	+/-	+	++	+	+	0	0	+/-
Q7: Ndrimet klimatike	+/-	?	0	+	0	0	+	?
Q8: Trashëgimia kulturore	0	+	++	0	+	0	0	0
Q9: Cilësia e jetës	+	+	++	+	+	0	0	+

Qëllimet e VSM- së	INFRASTRUKTURA TEKNIKE	
	Rrjeti i Ujësjellësit dhe Kanalizimit	Ujitja dhe Drenazhimi
	Qëllimi 1	Qëllimi 1
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	++	+
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	0	++
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	0	+
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	0	+
Q6: Ekosistemet	0	+
Q7: Ndririmet klimatike	0	+
Q8: Trashëgimia kulturore	+	+
Q9: Cilësia e jetës	++	+

Qëllimet e VSM- së	INFRASTRUKTURA TEKNIKE					
	Energjia Elektrike			Energjia Termike	Telekomunikimi	Menaxhimi i mbeturinave
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 1	Qëllimi 1	Qëllimi 1
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	0	0	0	+
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	+	0	0	+	?	+/-
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	0	0	0	0	0	+
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	0	0	0	0	0	+
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	0	0	0	0	0	0
Q6 Ekosistemet	0	0	0	0	0	+/-
Q7: Ndrimet klimatike	+/-	+/-	+/-	+	0	+
Q8: Trashëgimia kulturore	0	0	0	0	0	+
Q9: Cilësia e jetës	+	+	+	+	+	++

Qëllimet e VSM- së	INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI				
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	0	0	0
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	0	0	0	0	?
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	+/-	+/-	+	0	0
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	0	0	0	0	0
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	+/-	+/-	?	+/-	0
Q6 Ekosistemet	+/-	+/-	+/-	?	+/-
Q7: Ndririmet klimatike	+/-	+/-	+/-	+/-	?
Q8: Trashëgimia kulturore	0	0	0	0	0
Q9: Cilësia e jetës	+	+	+	+	+

Qëllimet e VSM- së	INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE				
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	0	0	0
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	?	?	?	?	?
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	0	0	0	0	0
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	?	?	?	0	0
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	0	+	0	0	?
Q6 Ekosistemet	?	?	0	0	?
Q7: Ndrrimet klimatike	?	+	+	0	?
Q8: Trashëgimia kulturore	?	?	0	0	?
Q9: Cilësia e jetës	+	+	+	+	+

Qëllimet e VSM- së	MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI					TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5	Qëllimi 1
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	+	+	++	+	+	?
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	++	+	+	+	?	?
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	+/-	+	+	+	+	?
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	+	?	+	++	+	0
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	++	+	++	+	?	+
Q6 Ekosistemet	+	?	+	+	+	+
Q7: Ndryshimet klimatike	+	+	?	?	+	0
Q8: Trashëgimia kulturore	+	+	+	+	++	++
Q9: Cilësia e jetës	+	+	+	++	+	+

Qëllimet e VSM- së	VENDBANIMET		VENDBANIMET JO FORMALE				BANIMI
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 1
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	+	+	?	0	?	?	+
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	++	+	?	?	0	0	?
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	+/-	+	+	+	+	+	+
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	0	?	0	?	0	0	0
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	+/-	?	0	?	0	0	0
Q6 Ekosistemet	+/-	+/-	0	0	0	0	+
Q7: Ndryshimet klimatike	+	+	+	+	+	+	+
Q8: Trashëgimia kulturore	?	?	?	0	?	0	0
Q9: Cilësia e jetës	+	+	+	+	+	+	+

Qëllimet e VSM- së	SHFRYTËZIMI I TOKËS								
	Qëllimi 1	Qëllimi 2	Qëllimi 3	Qëllimi 4	Qëllimi 5	Qëllimi 6	Qëllimi 7	Qëllimi 8	Qëllimi 9
Q1: Ajri: Reduktimi i emetimeve të gazrave serë	0	0	0	?	?	?	0	0	?
Q2: Rritja e cilësisë së ujit	+	?	+	+	?	+	+/-	+	+
Q3: Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës	+	+	+	+	+	++	++	+	+
Q4: Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve	+	+	?	?	?	+	+	?	?
Q5: Pyjet: Manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve	++	++	?	+	+	+	?	+	+
Q6 Ekosistemet	+/-	?	0	+	+	+	+	?	+
Q7: Ndryshimet klimatike	?	+	?	?	?	?	?	?	?
Q8: Trashëgimia kulturore	+	+	+	?	+	?	?	+	+
Q9: Cilësia e jetës	+	+	+	+	+	+	+	+	+

## SQARIM:

- ++ Përputhshmëri në nivel të konsiderueshëm;
- + Përputhshmëri e knaqshme;
- 0 nuk ka efekt;
- Konflikt i vogël i mundshëm;
- / - Konflikt i mundshëm domethënëse;
- + / - Elementet të puthshmërisë dhe konfliktit;
- ? Përputhshmëria nuk mund të vlerësohet në këtë fazë (nevojiten më shumë detaje se si do të arrihet qëllimi.

## 7.1. MASAT E NEVOJSHME NË PZHK PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

### 7.1.1. KONCEPTET ZHVILLIMORE TË PËRDORIMIT TË TOKËS, PËRFSHI ZHVILLIMIN E QENDRAVE

Në analizën e vendbanimeve është vërejtur se në Vushtrri, si në çdo vendbanim tjetër në Kosovë, kemi problem me shtrirjen shumë disperse (objekte të shpërndara) të ndërtimeve, të cilat më tutje paraqesin vështirësi në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, si dhe shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore, sidomos në zonën përgjatë rrugëve nacionale që lidhin Vushtrrinë me Prishtinën dhe Mitrovicën, përkatësisht përgjatë korridorit të Rruga N2.

Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës tregon destinimin për përdorim të tokës deri në vitin 2028+. Këtu prezantohen edhe kufijtë e rinj ndërtimor dhe zhvillime tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e një pjese të konsiderueshme të tokës me pjellshmëri, tokës së pasur me resurse dhe zonave pyjore në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Janë prezantuar edhe zona të shënuara me ngjyrë, të cilat potencialisht mund të paraqesin pika të nxehta mjedisore.

Konfliktet e mundshme për hapësira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshjeje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe dokumente tjera zbatuese për komunën, të cilat më pas do të vireshin në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale të Vushtrrisë. Gjatë procesit të hartimit janë organizuar takime me komunitetin për të filluar këtë proces. Rreziku kryesor mjedisor do të ishte nëse nuk arrihet marrëveshja për një vizion të përbashkët për Vushtrrinë.

Zhvillimi dhe rritja e Vushtrrisë besohet se do të vazhdojë; dhe sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë komuna, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo është e dëshirueshme dhe në të mirë të vendit, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimin efektiv komunal. Komuna e Vushtrrisë ka mundësi të akomodojë rritje të popullsisë përmes zgjerimit të kufijve ndërtimor dhe zhvillimit të zonave ekonomike, por kjo duhet të bëhet me kontroll dhe planifikim të kujdesshëm. Burimet ujore, përfshirë ato që lidhen me pellgun e Lumi Sitnica, kërkojnë mbrojtje të veçantë. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Vushtrrisë në parim nuk përbën problem, ndërkohë që sfidë mbetet menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financime të konsiderueshme në infrastrukturën mjedisore. Plani i njeh këto probleme dhe përpiqet të punojë brenda këtyre kufizimeve.

### 7.1.2. NDIKIMI NË KLIMË

Vushtrria vlerësohet se nuk ka indikacione që me aktivitetin aktual dhe atë që do të ketë në perspektivë të ndikojë ndjeshëm në klimën globale, pasi që komuna, përveç disa aktiviteteve prodhuese dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme, nuk ka industri të rëndë që do të emetonte gazra serrë në atë masë sa të kishte ndikim të konsiderueshëm global. Megjithatë, është e rëndësishme të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturave dhe faktorëve tjerë klimatikë në nivel lokal.

Komunikacioni rrugor, sidomos përgjatë rrugës nacionale N2 dhe lidhjeve rajonale, në mënyrë të pashmangshme do të ndikojë në mikroklimën lokale, duke ndikuar në ngritjen e temperaturave dhe praninë e ndotësve në ajër, ujë dhe tokë.

### 7.1.3. MBROJTJA E PYJEVE, ZONAVE TË GJELBRA EKZISTUESE DHE ZHVILLIMI I ZONAVE TË REJA

Destinimet për shfrytëzim të planifikuar të tokës të propozuara nga PZHK-ja krijojnë mundësinë për struktura të reja të pyjeve dhe zonave të gjelbra, duke krijuar habitate natyrore dhe mjedise atraktive në territorin e Vushtrrisë. Komuna duhet që në kuadër të zbatimit të planit të ketë prioritet:

- Projekte pyllëzimi konform planit;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirëmbajtje konform planit;
- Përcaktimin e numrit të këtyre strukturave që do të lejohen dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Projekte për ndërtim të infrastrukturës si rrugë malore me sistemim dhe drenazhim për zonat pyjore;
- Arkitekturën e objekteve për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues.

### 7.1.4. CILËSIA E AJRIT

Plani Zhvillimor Komunal adreson problemet e ajrit në aspektin e ndotjes dhe cilësisë së tij. Prania e komunikacionit përgjatë rrugëve nacionale dhe rajonale që kalojnë nëpër territorin e Vushtrrisë është një element që tregon shkarkim të konsiderueshëm të gazrave në atmosferë dhe lirim të zhurmave nga trafiku.

Rritja e parashikuar e trafikut deri në vitin 2028+ mund të ndikojë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit, veçanërisht për ndotës si Pb, SOx dhe NOx. Zbatimi i standardeve më strikte për emetimet nga automjetet, përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë së karburanteve, menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshirë përdorimin e shtuar të biçikletave dhe transportit publik, si dhe furnizimi i qëndrueshëm me energji, do të ndihmojnë në ngadalësimin e përkeqësimit të cilësisë së ajrit.

